

Kumbona e së Diellës



KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT
Nr.7/8, Korrik - Gusht 2012

A KA PËRPLASJE MES BIBLËS DHE SHKENCËS?!

Si e përshkruanin Shumerët krijimin e njeriut!

(Pjesë nga libri, Planeti i 12- të)

- Pjesa 8 -

Autori, shprehet se:

"libri në fjalë, nuk ka asnjë kundërshtim midis Biblës dhe Evolucionit.

"Libri i qëndron kohës", thotë autori, dhe "besoj unë, se na tregon të vërtetën për vet zanafillën tonë- dhe që, NE NUK JEMI VETEM."

ZECHARIA SITCHIN

Planeti i 12 -të

Tiranë, 2009.

KRIJIMI I NJERIUT

Eksperimentet në Institutin e Shkencave Shoqërore, të Etikës dhe Natyrës në Hasstings-on-Hudson, New York, kanë treguar se tashmë ekzistojnë teknika për të klonuar njerëzore. Tani është e mundur të merret materiali i bërthamës i çfarëdo qelize njerëzore (jo patjetër nga organet gjenitale) dhe me futjen njëzet e tre grupeve të kromozomeve të plota në vezën e femrës, të çojë në mbarsjen dhe lindjen e një individi të parapërcaktuar. Në mbarsjen natyrale, grupet e kromozomeve "at" dhe "amë" bëhen një e pastaj duhet të ndahen për të mbetur njëzet e tre çifte kromozomes, duke çuar në ndërthurje të rastit. Por në klonim pjella është një kopje e saktë me burimin e grupit të pandarë të kromozomeve. Tashmë i zotërojmë, sipas Dr. W. Gaulin-it nga Instituti, "njohurit e hatashme për të bërë kopje të sakta të qenies njerëzore", - një numër të pakufizuar Hitler-esh apo Moxar- tesh ose Ainshtai-nesh, (po të kishim ruajtur bërthamat të qelizave të tyre).

Por arti i inxhinierisë gjenetike nuk kufizohet në një proces . Kërkuesit në shumë vende kanë përsosur një proces të quajtur " shkrije qelizore" duke bërë të mundur të shkrihen qelizat në vend të ndërthurjes së kromozomeve brenda një qelize të vetme. Si pasojë këtij procesi, qeliza nga burimi të ndryshme mund shkrihen në një "mbi-qelize" e cila mban brenda vetes dy bërthama dhe një grup të dyfishtë kromozomes të çiftuara. Kur kjo qelizë ndahet, përzieja e bërthamave dhe kromozomeve mund të ndahet sipas një modeli të ndryshëm nga ai i secilës qelize para shkrires. Përfundimi mund të jenë dy qeliza të reja, secila e plotë gjenetiksht, por me një grup krejt të ri kodesh, gjenetike, plotësisht të ngatërruara për aq sa lidhej me qelizat paraardhëse.

Përsosur edhe më tej, procesi mund të na lejojë të zgjedhim cilat trajta të një forme jete do ti jepen qelizës së ndërthurur apo të "shkriret".

Kjo ka quar në zhvillimin e fushës së gjerë të "transplantit" gjenetik". Tani është e mundur të merret nga një baterie e caktuar një gjen i vetëm i posaçëm dhe të futet ai gjen në një qelize shtazore apo njerëzore duke i dhënë pjellës me veçori shtesë.



Papa Benedikti XVI KRISHTËRIMI KUMTON SHËLBIMIN	4
Dom Gjovalin Simonii UNGJILLËZIMI I RI	6
Ana Guzhda SHËN RROKU	10
Klajd Kapinova MJEDA NË PIEDESTAL	12
Ndue Dedaj BIBLA - PSIKOLOGU SHKOLLOR	21
Fatos Baxhaku BARONI I KRYENGRITËSVE	27
Dom Nikë Ukgjini MJEDA 6	30
FESTË PËR POETIN MJEDA	31
VITRINA E LIBRIT	32

KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXVII, nr. 7/8 (442-443) Korrik - Gusht 2012

Revistë
Fetaro-Kulturore
Drejtues
Imzot Angelo MASSAFRA

Redaksia
Dom Nikë Ukgjini (Kryeredaktor)
Atë Mario Imperatori S.I.
Dom Gjovalin Sukaj
Loreta Tomaj

Adresa:
Arqipeshkvia Shkodër
Sheshi Gjon Pali II
Tel. 0222-42764
Fax. 0222-43673
e-mail: n_ukgjini@yahoo.it
Web page: kishakatolikeshkoder.com

Redaktor teknik: Xhon NIKA

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

KRISHTERIMI NUK KUMTON SHËLBIMIN ABSTRAKT, PREMTON JETËN E PASOSUR

SOLEMNITETI I TË NGJITURIT TË ZOJËS NË QIELL

Krishterimi nuk kumton shëlbimin abstrakt të shpirtit në një botë të përtejme të papërcaktuar; premtion një jetë të pasosur, ku asnjë nga gjërat që duam shumë, nuk shkatërrohet, por vijon të jetojë, për hir të Zotit. Këtë thekson Kisha me Solemnitetin e Të Ngjiturit të Zojës së Bekuar në Qiell duke i ftuar gjithë të krishterët ta ndërtojnë që tani këtu, mbi tokë, botën e re, që nuk do të ketë kurrë mbarim.

“Ne besojmë se Maria, ashtu si Krishti, Biri i saj, e mundi vdekjen e tani ngadhënjën në lumninë qiellore me gjithë qenien e saj: me shpirt e me korp”. Ky formulim i dogmës të Të Ngjiturit të Zojës në Qiell, është shpallur mase 60-vjet më parë nga Papa Piu XII. Maria, pra, na parapriu, po ku duhet t'i kërkojmë rrënjët e kësaj fitoreje mbi vdekjen, që u përshpejtua mrekullisht në Marinë, pyeti Benedikti XVI më 15 gusht 2010:

“Rrënjët janë në fenë e Virgjërës së Nazaretit... fe që është bindje e plotë ndaj Fjalës së Zotit e lëshim i plotë i vetvetes në duart e Tij hyjnore... Tek Feja, pra, qëndron madhështia e Marisë që, siç e shpall galdueshëm Elizabeta, “është e bekuar mbi të gjitha gratë”, sepse e beson dhe e jeton në mënyrë të pashembullt lumninë e parë, atë të fesë”.

Por Maria, e ngjitur në qiell, nuk është larg nesh, pohoi Papa, i cili vijoi të shpjegonte kuptimin e fjalës 'qiell':

“Ne të gjithë sot jemi të vetëdijsëm se me termin 'qiell' nuk duam të tregojmë ndonjë vend të gjithësisë... jo! Termi shënon diçka shumë më të madhe e më të vështirë për t'u përkufizuar me konceptet tona të kufizuara njerëzore. Me termin “qiell” duam të pohojmë



se Zoti, Hyji, që u bë i afërmi ynë, nuk na braktis as në vdekje e as përtej saj, përkundrazi, Ai ka bërë gati një vend për secilin nga ne, Ai na dhuron amshimin”.

Për ta shpjeguar këtë realitet, Benedikti XVI u kujtoi besimtarëve të dashurit e vdekur. Ata i mbyllën sytë përgjithmonë për dritën e kësaj toke e megjithatë janë gjithnjë të pranishëm. Duke e kryer shtegtimin e tyre këtu poshtë, na lanë në zemra një gjurmë të pashlyeshme, që na kujton se një pjesë e tyre vijon të jetojë në shpirtin tonë. Ata jetojnë pranë nesh, por janë si hije, sepse edhe kjo mënyrë e të jetuarit e të dashurve, mbaron një ditë, bashkë me ne. Por na ngushëllon mendimi se:

“Zoti nuk mbaron kurrë e ne të gjithë jetojmë për virtyt të forcës së dashurisë së Tij; jetojmë sepse ai na do, sepse ai na krijoi, na thirri në jetë. Ne ekzistojmë në mendimet e në dashurinë e Zotit. Ekzistojmë në të gjithë realitetin tonë, jo vetëm në 'hijen' tonë. Qetësia jonë, shpresa jonë, paqja jonë e kanë themelin pikërisht në Zotin, në dashurinë e tij krijuese, që na ruan e na mban gjatë gjithë jetës sonë e na prin në amshim. Është dashuria e Tij ajo, që e mund vdekjen e na dhuron jetën e pasosur, e pikërisht këtë dashuri e quajmë “qiell”: Zoti është aq i madh, sa ta ketë një vend edhe për secilin nga ne”.

Jezusi, që është Zot i vërtetë e njeri i vërtetë, vijon Papa, është garancia jonë. Na siguron se njeriu e Hyji mund të ekzistojnë e të jetojnë në përjetësi njëri në tjetrin.

Kjo do të thotë se nga secili prej nesh nuk do të vijojë të ekzistojë vetëm një pjesë, që mund të themi se shkëputet nga ne, në sa pjesët e tjera shkatërrohen; do të thotë se Zoti e njeh dhe e do njeriun në tërësi, ashtu si është:

“E Hyji pranon në amshimin e tij atë, që tani, në jetën tonë, gatuar me vuajtje e me dashuri, me shpresë e pritje, me gëzime e trishtime, rritet e plakët. I gjithë njeriu, e gjithë jeta e tij merret nga Zoti dhe, e pastruar në Të, fiton amshimin. Të dashur miq! Unë mendoj se kjo është një e vërtetë, që duhet të na mbushë me gëzim të thellë. Krishterimi nuk kumton vetëm shëlbimin e shpirtit në një jetë të përtejme, krejt të papërcaktuar, në të cilën gjithçka patëm të çmuar e të dashur mbi këtë tokë, zhduket përgjithnjë, si shkumba e valëve, por premton jetën e pasosur, “jetën e botës, që do të vijë”: asgjë nga ç' patëm të çmuar e të dashur nuk do të shkatërrohet, por do të gjejë përkryerjen e vet të plotë në Zotin”.

Krishterimi, theksoi Ati i Shenjtë Jozef Ratcinger, jep një shpresë të fortë, dhuron një ardhmëri të ndritur e ne jemi të thirrur, pikërisht si të krishterë, ta ndërtojmë këtë botë të re, të punojmë për ta bërë një ditë 'botë të Zotit', botë e cila do ta tejkalojë atë, që mund të ndërtojmë ne. Në Marinë e ngjitur në Qiell, pjesëtare e plotë e Ngjalljes së Birit, ne kundrojmë realizimin e krijesës njerëzore sipas 'botës së Zotit'.

E Papa ne përfundim na drejton ftesën:

“Ta lusim Zotin të na ndihmojë për të kuptuar sa e çmuar është para syve të Tij gjithë jeta jonë; të forcojë në shpirtin tonë besimin në jetën e pasosur; të na bëjë njerëz shprese, që punojnë për të ndërtuar një botë, e cila ia hap plotësisht portat Zotit; njerëz plot gëzim, që janë në gjendje ta shijojnë bukurinë e botës së ardhshme edhe në mes të trazirave të jetës së përditshme, e me këtë siguri jetojnë, besojnë, shpresojnë”.

Kujtojmë se nderimi për Virgjërën Mari nis që në zanafillë të Kishës. Artistë të të gjitha epokave, nënvizoi, e pikturuan dhe e skalitën shenjtërinë e Nënës së Zotit, duke zbukuruar kisha e shenjtërore. Poetë, shkrimtarë, muzikantë e shprehën nderimin e tyre të thellë për Nënë e Virgjër të Zotit, duke krijuar himne e këngë mahnitëse liturgjike. Nga vendi ku lind dielli e deri atje ku perëndon, e Gjithëshenjtja u quajt Nënë Qiellore, që mban Birin e Hyjit në ato krahë, të cilët mund të përfshijnë, në një përqafim kozmik, mbarë njerëzimin, sepse Zoja e Bekuar është strehë për të gjithë ata, që kërkojnë ndihmën e saj amtare. E Papa Benedikti XVI më 15 gusht 2010 në Kastelgandolfo tha një lutje të lashtë, drejtuar Zojës:

“Nën mbrojtjen tënde kërkojmë strehë, Nënë e Shenjtë e Zotit: mos i përbuz lutjet, që të drejtojmë, në çaste prove, por na shpëto nga çdo rrezik, o Virgjër e lume dhe e bekuar”



Dom Gjovalin Simoni
Shkodër

UNGJILLËZIMI I RI MËNYRË E RE PËR TË QENË KISHË

*“Është koha për një Ungjillëzim të ri edhe për botën perëndimore,
ku edhe pse janë të pagëzuar, jetojnë krejt jashtë jetës së krishterë”*

Gjatë këtij viti jemi duke medituara mbi temën e ungjillëzimit të ri e cila është një temë që ka preokupuar shumë Papë, si një sfidë e hapur për kohën bashkëkohore. Nisur nga ky fakt, Papa Pali VI, solli dokumentin e rëndësishëm *“Evangelii nuntiandi”* që ishte pikë referimit për ecjen e mëtejshme të formave dhe praktikave të reja të ungjillëzimit që në kohën moderne, deri në ditët e sotme. Më pas i Lumi Gjon Pali II, e ka pasur shumë për zemër, këtë temë. Ai e ka promovuar dhe propozuar mbarë Kishës termin: “Ungjillëzimi i ri”. Po kështu edhe Papa Benedikti XVI, duke parë rëndësinë e një ungjillëzimi më efikas dhe njëherazi duke u ballafaquar me sfidat e kohës moderne e bashkëkohore, ka menduar që t’i japë një hapësirë të veçantë, misionit të tij, duke dashur t’i vijë në ndihmë, jo vetëm pjesëtarëve të Kishës, por dhe duke hapur një mundësi të re dialogu edhe me jo besimtarët. Quhet ungjillëzim “i ri” jo në kuptimin se është vjetërsuar ungjilli dhe ka dalë jashtë mode, dhe tani po sjellim një ungjill të ri, (sepse Fjala e Zotit është e re gjithmonë) por, quhet “i ri”, në zellin e tij për të shpallur Lajmin e mirë, në metodat e reja dhe në mënyrat e shprehjes, duke i ardhur në takim çdo njeriu të kohës së sotme.

Jo pa qëllim, Benedikti XVI ka dashur që tema e ungjillëzimit të ri të përputhet me *Vitin e Fesë*, sepse nuk mund ta shpallim ungjillin e Krishtit nëse nuk kemi një përvojë feje të fortë dhe personale me

Të. Prandaj, gëzimi i takimit me Krishtin, është ajo forcë, që na shtynë për ta bashkëndarë me të tjerët, besimin tonë që kemi në Zotin. Forca e tij është aq e madhe saqë nuk mund të mbahet vetëm për vetë. Kështu pra, Kisha, Barinjtë e saj e besimtarët, duhet të qëndrojnë të bashkuar me Krishtin për ta udhëhequr popullin jo besimtar prej shkretëtirës, drejt jetës, drejt miqësisë së Birit të Njeriut, drejt Atij që na e jep jetën dhe na e jep në plotësi.

Shpesh herë, sot, shqetësimet e tepërta të rrjedhëve shoqërore, politike e kulturore kanë marr përparësi në jetën e njeriut, duke e bërë që të mendohet shumë pak për besimin e ndërsjelle ose më mirë të mendohet shumë pak për Zotin. Prandaj tema e Ungjillëzimit të ri dhe nxitja e Papës mbi këtë argument nuk është thjeshtë një promovim idesh, por një ftesë që njeriu të *“kthehet dhe t’i besojë ungjillit”* (Mk 1,14). Duhet ta ndiejmë nevojën si samaritanja që shkoi tek pusi për të mbushur ujë dhe të shuajmë etjen e vërtetë e të rifreskojmë rrënjët e fesë në atë burim uji të gjallë (Gjn 4,10).

Dërgimi i nxënësve në mision, tregon qartë dhe zemrën misionare të vetë Jezusit, i cili nuk kufizohet vetëm në rrethin e popullit të Izraelit, por i hap krahët për të përqaftuar mbarë njerëzimin, ashtu siç bëri edhe në momentin kulmor të jetës së tij mbi kryq. Kështu, duke u ngjitur në qiell, Ai u la





këtë “amanet” (porosi): *“Shkoni e bëni nxënës të mi të gjithë popujt! Pagëzoni në Emër të Atit e të Birit e të Shpirtit Shenjt! Mësoni t’i zbatojnë gjithçka ju kam urdhëruar! Dhe ja, unë jam me ju gjithmonë-deri në të sosur të botës!”* (Mt 28, 19-20). Por, në këtë mision, nxënësit nuk janë vetëm, Jezusi u premton dërgimin e Shpirtit Shenjt (Gjn 14,16) dhe premtimin tjetër ngushëllues “unë jam me ju gjithmonë-deri në të sosur të botës” (Mt 19,20). Nga ky ngushëllim marrim forcë edhe ne për të përhapur Fjalën e Tij. Por në të njëjtën kohë edhe shpallja e Ungjillit bëhet *objektive*, sepse ne nuk u shpallim njerëzve vetveten, por u shpallim Jezu Krishtin, Lajmin e gëzueshëm; shpallim këtë ngushëllim: “mos ki frikë, Zoti është me ty, gjithmonë”!

Në misionin tonë, ndodh që të biem nga njëherë, në një gjendje si ajo e dishepujve të Emausit (krh Lk 24, 13-35), një gjendje dëshpërimi. Sikur, kur shpallim lajmin për një të vdekur, tregojmë frustrimet tona psikike dhe shpirtërore, mbetemi të pa shpresë etj... Kjo bën që ne të përçojmë tek të tjerët një kuptim të rremë dhe një shtrembët për Krishtin dhe për Kishën, sepse jemi ne që e shfaqim një dëshpërim të tillë.

Por, ne duhet të marrim përvojën e takimit të nxënësve me Jesusin e Ngjallur, dhe ky takim i Tij ta shënojë fuqishëm jetën tonë. Pas këtij momenti, atëherë, nuk jemi ne që flasim por është Shpirti i Tij

që flet në ne duke përdorur njëherazi dhe cilësitë tona njerëzore. Në lidhje me këtë argument edhe Ipeshkvijtë e Sinodit kanë theksuar: *“e gjithë kjo situatë na bën ta shohim problemin jo vetëm si të jashtëm, por edhe brenda Kishës në të qenurit e saj dhe në të jetuarit e saj. Kështu, pastaj mund të kuptohen edhe problemet në lidhje me pafrytshmërinë e ungjillëzimit të sotëm, të katekizmit modern; që tregojnë se Kisha nuk duhet të jetë një makineri ose një ndërmarrje, por duhet të jetë një bashkësi e vërtetë dhe një vëllazëri e vërtetë”*.

Duke u nisur nga kjo situatë, nga kjo gjendje kishtarë dhe shoqërore, bëhet më i qartë mësimi i Konkilit II të Vatikanit ku thekson se Kisha, nga natyra saj është misionare, d.m.th se dhe identiteti i saj është i tillë. Misioni i Kishës, buron nga misioni i Krishtit e i Shpirtit Shenjt, sipas planit të Atit. Ky mision i Kishës është i dyfishtë dhe reciprok, sepse Kisha dukë shpallur Ungjillin jo vetëm që pasuron dhe u jep Lajmin e mirë të gjithëve, por si gjithmonë pasurohet dhe ungjillëzohet edhe brenda vetës.

Prandaj, tani le të shohim se si ungjillëzimi ose misioni i Kishës mund të jetë *“ad intra”* dhe *“ad extra”*, pra nevoja e Kishës për një ungjillëzim të brendshëm dhe pastaj edhe në mision drejt të tjerëve.

Ungjillëzimi i ri: misioni i Kishës “ad intra”

Në prag të shpalljes se Ungjillit të tjerëve, është mirë që t'ia shpallim më parë vetës ose ta lëmë vetën që të përshkohemi nga ajo Fjala Ungjillore. Sepse vetëm nëse ushqehemi nga Lajmi i mirë (Ungjilli) do të mund të përçojmë tek të tjerët ngushëllimin e Zotit. Prandaj dhe Shën Pali në letrën drejtuar nxënësit të tij Timoteut, e porositë që të ketë kujdes së pari vetveten: *“Mos e lër pas dore hirin që është në ty, i cili të qe dhënë në sajë të profecive dhe me vënien e duarve të kolegjit të pleqëve (presbyteroi). Kujdesohu për këto, jepu tërësisht pas tyre, që përparimi yt të jetë i dukshëm për të gjithë. (Vigjilo)Vërja mendjen vetës dhe mësimi! Të jeshë i qëndrueshëm në këto gjëra! Sepse duke vepruar kështu do të shëlbosh vetën dhe ata që të dëgjojnë”* (1Tim 4,14-16). Shën Pali, kërkon Timoteut që të ketë kujdes për vetën e tij dhe për botën e tij të brendshme, sepse vetëm në këtë mënyrë “përparimi yt do të jetë i dukshëm për të gjithë” d.m.th, që dëshmia personale do të rrezatojë të vërtetën e Zotit dhe do të tregojë se jeta jote është një jetë me Zotin. Kujdesi për vetën nuk është një justifikim i një komoditeti, as një shprehje egoiste, por thjeshtë një kujdes i nevojshëm i cili shndërrohet pastaj në një kujdes dhe dashuri për tjetrin. Në rrethanat tona Kishtare, vihet re një punë baritore që në fakt nuk ka dyshim që buron prej një shpirti të mirë e bujar ndaj popullit të Zotit. Secili në famullinë, apo në detyrën e vet, duke dhënë maksimumin e mundshëm, sakrifikon shumë për të tjerët. Por, rreziku qëndron në faktin se krijohet një shpëputje, mes asaj që bëjmë e themi, dhe thirrjes sonë si misionar që konsiston në faktin, se Jezusi na ka thirrur së pari për të qëndruar me Të, pastaj dhe të predikojmë Ungjillin (krh Mk 3,14). Kjo kohë e qëndrimit me Të (me Jezusin) nuk është kohë e humbur ose nuk është më pak efikase se sa ajo e punëve baritore, ku shpesh herë krijojmë iluzionin së pa ne, nuk mund të behët asgjë. Sikur harrojmë se Krishti na thotë: “pa mua nuk mund të bëni asgjë” (Gjn 15,5).

Prandaj, misioni i Kishës përballë njerëzve varet shumë, ose më mirë te themi se varet nga cilësia jonë misionare. Papa, Benedikti XVI, në lutjen gjatë javës, *Engjëllit i Zotit*, për bashkimin e të krishterëve ka pohuar se bashkimi i krishterë nis nga kthimi personal i gjithsecilit, nga shndërrimi personal, i cili na bën të gatshëm për t'iu hapur



dëshirës së Krishti- “që të gjithë të jenë një”! Papa thekson: “ne mund të arrijmë me të vërtetë në cakun e bashkimit të plotë, vetëm në se e lëmë Zotin të veprojë. Njësimi i dukshëm i gjithë të krishterëve, është përherë vepër, që vjen nga lart, nga Zoti. Është vepër, që kërkon përvujtëri, kërkon njohjen e ligështive tona e pranimin e dhuratës së Zotit. Por, në se përdorim një shprehje, që e përsëriste shpesh i Lumi Papa Gjon Pali II,” çdo dhuratë bëhet vetvetiu edhe impenjim. Prandaj duhet kujtuar se njësimi, që vjen nga Zoti, kërkon edhe impenjimin tonë të përditshëm, kërkon t'ia hapim zemrat njëri-tjetrit, me dashuri të krishterë”.

Nëse, Papa mendon se kjo është rruga për të gjithë të krishterët aq më tepër kjo duhet të ndikojë edhe në Kishën tonë lokale. Sepse ashtu si në çdo Kishë kemi nevojë që t'i hapemi dhuratës së Zotit për të pranuar hirin e tij që na shndërron brendësinë tonë dhe pastaj që të shfaqet edhe në punën tonë baritore. Mungesa e bashkimit dhe dashurisë vëllazërore brenda Kishës, bën që të humbet besueshmëria në të. Prandaj me të drejtë Kardinal J.H. Newman thotë: “Shpesh herë nuk i prekim deri në rrënjë plagët e natyrës sonë njerëzore. Në vend që t'i hedhim themelet e fesë sonë në brendësinë tonë, pastrojmë vetëm pjesën e jashtme. Jemi të mirësjellshëm dhe shoqërorë me njëri-tjetrin, me fjalë e me vepra, por dashuria mes nesh nuk rritet. Kemi frikë të bashkëndajmë thellësitë tona shpirtërore dhe si pasojë, feja jonë duke u parë vetëm si një sistem shoqërorë, mbetet bosh. Në të nuk shihet prania e Krishtit”

Ajo që e bën Kishën dhe pjesëtare e saj të besueshëm, është kur në to, shkëlqen fytyra e Zotit me dashurinë dhe mëshirën e Tij të pakufi. Kjo arrihet nëse ne të parët e lejojmë vetën të ndriçohemi nga kjo dritë me anë të lutjes dhe

takimit tonë personal me Jezusin. Ja, atëherë, kujdesi për vetën shndërrohet në një fryt për misionin e Kishës.

Shën Karlo Borromeo e porositi klerin e tij me këto fjalë: *“A e ushtron kujdesin për shpirtin?! Por mos e lë pas dore kujdesin për vetën tënde, dhe mos iu jep të tjerëve deri në pikën që mos të mbetet asgjë ty nga vetja jote. Duhet ta kesh parasysh kujtimin e shpirtit bariu i të cilëve je, por mos e harro vetveten. Kuptojeni, vëllezër se asgjë nuk është më e nevojshme për personat kishtarë se sa meditimi që paraprin, shoqëron dhe përcjell çdo vepër tonën. Nëse mbarëson sakramentet, o vëlla, medito për atë që bën. Nëse e kremton meshën, medito për atë që po dhuron”.*

Ungjillëzimi i ri: misioni i Kishës “ad extra”

Fjalët e Jezusi të fundit që ua la nxënësve të vet sipas ungjillit të Markut, tregojnë qartë dimensionin e ungjillëzimit i cili kapërcen çdo kufij: *“Shkoni në mbarë botën e predikoni ungjillin çdo krijesë”* (Mk 16,15). Natyrisht, nxënësit dalin për përhapjen e ungjillit, vetëm pasi të janë mbushur më Shpirtin Shenjt dhe të janë të siguruar më praninë e Krishtit, që është gjithmonë besnik fjalës së dhënë. Nxënësit, kane pasur parasysh dhe mospranimin e tyre në shumë vende si dhe persekutimet që do t’iu ndodhin, por kjo nuk e ndaloj zellin e tyre ungjillëzues. Mësime të marra nga Jezusi, u kanë dhënë siguri dhe bindje, së vetëm duke bashkëndarë, Lajmin e Mirë (Ungjillin) më të tjerët, mund të gjendet gëzimi i vërtetë i Zotit. Lajmi i Mire, është i drejtuar të gjithë njerëzve, por në mënyrë të veçantë, të varfërve të vegjëlve të nëpërkëmburve. Mensa e Krishtit, ishte e rrethuar edhe nga mëkatarët dhe tagrambledhësit, gjë që nuk shihej me sy të mirë nga farisenjtë, por Jezusi këmbëngulte në mbrojtjen edhe të tyre duke thënë: *“mjeku u duhet të sëmurëve”*. Kisha jonë nëse do të lirohej shpeshherë nga paragjykimet, ndoshta do e mbushte mensën me njerëz të kësaj natyre dhe rruga e shëlbimit do ishte më efikase. Është koha që të shohim më një sy tjetër, hapësirën e madhe, kishë - populli i thjeshtë,

mëkatarë të drejt. Ndoshta rrezikojmë të vetë përjashtohemi nga rreshti i atyre “të sëmurëve” që kanë nevojë për Mjekun! Që të shkojmë drejt këtyre njerëzve, kemi nevojë të jemi të lirë dhe të shëruar dhe ne nga mëshira e Zotit, sepse ne, jemi Kishë, d.m.th, popull i Zotit në ecje drejt mbretërisë së Tij. Populli ka nevojë për ne dhe ne për popullin, kemi nevojë të jemi të bashkuar në këtë shtegtim tokësorë.

Hapja ndaj Kishës Universale na bën dhe më guximtarë, më të përgjegjshëm në misionin tonë. Kur hyjmë në këtë logjikë, zemra zgjerohet sepse me të drejtë ndihemi pjesë e Trupit të Krishtit të përhapur në mbarë botën dhe puna e jonë baritore merr një rëndësi universale për mbarë kishën. Prandaj, porositë e Jezusit, për ne: *“I mjeri unë nëse nuk e shpalli Ungjillin e Krishtit”* (1Kor 9,16), duhet të shndërrohet në një përgjegjësi personale.

Themi se forca më efikase e shpalljes së ungjillit qëndron në fjalët e Jezusit sipas ungjillit të Shën Gjonit: *“nëse do ta doni njëri tjetrin, të gjithë do t’ju njohin se jeni nxënës të mi”*. Duke dashur njëri tjetrin dëshmojmë se duam dhe vetë Jezusin dhe njëkohësisht duam edhe Kishën. Dashuria për Zotin dhe për të tjerët (d.m.th. dëshmia konkrete e jetës), është mënyra më efikase e shpalljes së ungjillit.

Virgjëra Mari, Nëna e Kishës dhe Nëna e Këshillit të Mirë na ndihmoftë që të jemi gjymtyrë të denja të Trupit të Krishtit dhe që të jetojmë gjithmonë të lidhur me Të si shermendi me hardhinë, në mënyrë që të japim shumë fryt dhe fryti ynë të jetë i qëndrueshëm.



SHËN RROKU - MBROJTËS NGA MURTAJA

Shën Rroku është shenjt i kishës katolike romake, shumë i njohur në Evropë dhe ndër katolikët shqiptarë.

Vdekja e tij përkujtohet me 16 gusht dhe është shenjt mbrojtës kundër murtajës.

Emri i tij në gjuhët e ndryshme veçohet si, Rokus në latinisht ; Roko në italisht dhe Rokue-spanjisht dhe portugalisht.

Sipas, biografëve, Shën Rrokut, lindi në Montpelje të Francës rreth vitit 1295. Babai i tij ishte guvernator (qeverisësi) i Montpeljes. Edhe lindja e tij lidhet me një mrekulli, pasi që e ëma ishte shterpë.

Gjersa ajo iu lut Virgjërës Mari, ndodhi që të jetë (apo te mbete) shtatzënë. Sipas një legjende, gjatë kohës së lindjes së tij, iu gjet mrekullisht një shenjë kryqi i kuq në gjoks, që rritej me kalimin e kohës. Ai, që në fëmijëri, filloi të ushtronte një asketizëm të rreptë dhe një përkushtim të madh ndaj Zotit. Në ditët kur nëna e tij në shenjë përvujtërie agjëronte dy herë në javë, Rroku, ai do të mëkohej një herë atë ditë" (Legenda Aurea).

Ditën e vdekjes të prindërve të tij, kur ai ishte 12 vjeçar, shpërndau gjithë pasuritë e tij të varfërve si Shën Françesku. Edhe megjithëse babai i tij në shtratin e vdekjes e emëroi atë guvernator të Montpeljes, ai mori rrugët se (si) një shtegtar dhe lypsar , veti kjo që e përcolli tërë jetën.

Gjatë një udhëtimi në Itali, kur atje mbretëronte epidemia e murtajës, ai nuk ngurroi të ndihmonte të sëmurët nëpër spitalet e Acquapendentes, Cesenas dhe Romës, ku thuhet se do ketë kryer shumë shërime mrekullibërëse me anë të lutjes dhe shenjës së kryqit. Në Romë kishte shpëtuar kardinalin e Anglerisë në Lombardi, duke bërë shenjën e kryqit në ballin e tij, (Legenda Aurea). Duke shërbyer në Piacenza u sëmur edhe vetë. I dëbuar nga qyteti u tërhoq në pyll, duke jetuar (në) një kasolle, ndërtuar prej degësh e gjetesh. Ai, nga sëmundja

do të vdiste nëse nuk do të ishte një qen që i përkiste një fisniku të pasur të quajtur Gothard dhe që atij do i sillte bukë. Fisniku Gothard, një ditë pasi e ndoqi qenin e tij që çonte bukën Shën Rrokut, u njoh me të duke u miqësuar ndërmjet veti.

Me kthimin e tij fshehtazi në Montpelje u arrestua me padinë e spiunazhit dhe u fut në burg, ku qëndroj për pesë vjet duke ndërruar jetë më 16 gusht 1327. Pas vdekjes së tij, Legenda Aurea, për jetën e tij në burg, thotë se" një engjëll në burg ia kishte sjellë nga qielli një rrasë hyjnore të shkruar me shkronja të arta, të cilën Engjëlli ai (ia) vendoste nën kokën e Shën Rrokut. Në atë rrasë shkruhej se Perëndia i kishte dëgjuar lutjet e tija, dhe që kush do që do thërriste më përvujtëri Shën Rrokun nuk do të sëmuret nga ndonjë plagë murtaje."



Shën Rroku u bë i njohur në botë nga shenja e lindjes, kryqi i kuq në gjoks. Ai se shpejti u kanonizua nga Kisha katolike.

Kur Këshilli i Konsatncës në vitin 1414, po kërcënohej nga sëmundja e murtajës, nga etërit e kishës u urdhërua të celebrimet mesha dhe të organizohen lutje popullore, për ndërhyrjen e Shën Rrokut, për ta ndaluar përhapjen e sëmundjes së pa shërueshme për kohën.

Kulti i tij, pas vdekjes që përhapur në Spanjë, Francë, Belgjikë, Itali dhe Gjermani, si mbrojtëse nga vdekja e zeze, siç konsiderohej sëmundja e

murtajës. Relikat (eshtrat) e tij u dërguan fshehtëazi në vitin 1485, në Venecia, ku ende sot ndodhen. Shën Rroku mendohet që i përkiste "Urdhrit të Tretë" të Shën Françeskut. Populli shqiptar e nderon Shën Rrokun duke ia kushtuar disa kisha këtij shenjti mrekullibërës, në Shqipëri, kisha e Shirokës e Bushatit, dhe në Kosovë, kisha e Novollës etj.

Në nder të emrit të tij janë themeluar Vëllazëri të shumta. Ai shpesh paraqitet me veshjen e një shtegtari, me një plagë në kofshën e këmbës i shoqëruar nga qeni besnik i cili i dërgonte buke gjate qëndrimit të tij në shpellë.



KLAJD KAPINOVA
New York

DOM NDRE MJEDA RIVJEN ME PIEDESTAL MES BANOREVE TË SHKODRËS Bushat-Kukël, 1 gusht 2012

*Zhvilloi punimet me sukses Konferenca Shkencore kushtuar Ndre Mjedës
me rastin e 75-vjetorit të vdekjes dhe 100 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë*



Gjatë gjithë vitit kam ndjekur nga afër punën e palodhur të hulumtuesit Dr. Mentor Quku, përkushtuar rilindasit të shquar erudit, patriotit dhe poetit brilant Dom Ndre Mjeda. Po këto ditë përmes telefonit, zhvillova një bisedë, me një ndër organizatorët kryesorë studiuesin. Mentor Qukun, nga i cili mora një informacion më të plotë, mbi zhvillimin e punimeve me sukses të Konferencës Shkencore kushtuar Ndre Mjedës në 75-vjetorin e vdekjes dhe 100-vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, mbajtur në

komunën Bushat të rrethit Shkodër (1 gusht 2012).

Në përurimin bustit dhe sesionin shkencorë morën pjesë studiues të afirmuar në shkencat albanologjike, shkrimtarë, artistë dhe personalitete të shquara të artit dhe shkencës shqiptare nga të gjitha trevat shqiptare dhe diaspora.

Konferenca shkencore në Bushat
Konferenca u organizua nga Qendra e Studimeve Albanologjike, Qendra Muzeore

“Ndre Mjeda” dhe Komuna e Bushatit. Punimet që u mbajtën në sallën e konferencave të Komunës së Bushatit, u hapën nga drejtori i QQS, Prof. dr. Ardian Marashi, i cili, në mes të tjerave theksoi, se: “Kjo Konferencë, provon interesimin e madh që ka ngjallur jeta dhe vepra e Ndre Mjedës në rrethet shkencore”. Të pranishëm ishin gjithashtu deputetët e parlamentit shqiptar Mark Marku dhe Gjokë Uldedaj, si edhe personalitete fetare e kulturore. Kishin ardhë nga SHBA Dom Anton Kçira, Dom Ndue Gjergji, piktori Astrit Tota, shkrimtari Kolec Traboini dhe studiuesi Tomë Mrijajetj.

Kryetari i komunës së Bushatit, Zef Hila, u uroj mysafirëve mirëseardhjen, si edhe foli për rëndësinë, që ka organizimi i kësaj veprimtarie shkencore dhe përkujtimore, që po mbahet në Bushat, për zhvillimin e turizmit kulturor në këtë zonë.

Seanca e parë, u drejtua nga Prof. dr. Shefkije Islamaj, Prof. dr. Mustafa Ibrahimiri dhe Prof. dr. Mimoza Priku. Shefja e katedrës së letërsisë në Universitetin “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës, Dr. Elinda Ramadani, ligjëroi një studim kontribues mbi krijimtarinë artistike për fëmijë të Ndre Mjedës. Ajo trajtoi shkencërisht problemin e shumë debatueshëm të autorësisë Mjeda-Xanoni. Prof. As. Dr. Mark Marku, pedagog i Universitetit të Tiranës, ia kushtoi ligjeratën e tij natyrës së ngjeshur të stilit të Mjedës, duke u mbështetur kryesisht në kulturën klasike, që mori në seminarët jezuite. Ndërsa pedagogu i Universitetit të Prishtinës, Prof. As. Dr. Begzad Baliu, referoi ligjeratën: “Rilindja e Mjedës, kërkime në kolanën përgatitur nga Mentor Quku”.

Më pas, gjuhëtari i njohur, akademik Gjovalin Shkurtaç, mbajti ligjërata të “Përbashkësia e gjuhës si dëshmi e njësisë së kombit shqiptar në veprat e Mjedës”. Në kumtin e tij, ai u ndal në katër çështje: Vjershëria e Ndre Mjedës, ka “vulë” të dukshme e të theksuar atdhetarie; Ato janë kushtim për ruajtjen dhe mbrojtjen e tërësisë truallësore të kombit e popullit shqiptar;

Askush më bukur, po edhe aq me forcë e ndikim në thelb të zemrës së popullit, nuk i ka kënduar njësisë dhe përbashkësisë së dy dialekteve të shqipes, sa Ndre Mjeda; Onomastika shqiptare e Shqipërisë dhe e trevave të saj dhe antroponimia artistike në vjershat e poemat e Mjedës si përthekuese të idesë së përbashkësisë etnike dhe e ruajtjes së visareve të mëdha amtare e gjuhëruajtëse. Prof. Dr. Klara Kodra, përfaqësuese e QSA, kumtoi temën e saj të preferuar: “Veçoritë gjinore të veprës së Mjedës”.

Seanca e parë, u përmbyll me studimin e Dr. Tonin Çobanit: “Poema Lissus, rilexim”, përmes të cilit solli risi lidhur me komentin e kësaj kryevepre të letërsisë shqipe. Ai solli interpretime me vlerë, lidhur me perënditë ilire e veçanërisht Bahtin Ilir, i cili, sipas tij është themeluesi i vërtetë i qytetit të Lissus-it. Mbas një pushimi të shkurtër, filloi punimet seanca e dytë e konferencës, e cila u drejtua nga Akademik Gjovalin Shkurtaç, Prof. As. Dr. Begzad Baliu. U lexuan shtatë ligjerata, që ngjallën interes nga auditori i pranishëm. Punimet e seancës u hapën me studimin e pedagogut të Universitetit të Shkodrës, Prof. dr. Alfred Çapaliku, i cili, referoi lidhur me artin tek poezitë e Mjedës, kushtuar katër stinëve të vitit, si edhe për nëntekstin filozofik të tyre.

Punonjësja shkencore e Institutit Albanologjik të Prishtinës, Prof. dr. Shefkije Islamaj, kumtoi studimin “Mjeda - mjeshtër i gjuhës”, ku, trajtoi rreth kontributeve të shquara të Mjedës në gjuhësinë shqiptare. Vazhdoi me ligjërimin e tij profesori i Universitetit të Europës Jug Lindore të Tetovës, Prof. asoc. dr. Mustaf Ibrahimiri, “Frazologjizmat në veprat e Ndre Mjedës”. Kurse dekania e shkencave shoqërore në Universitetin “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës, Prof. as. dr. Mimoza Priku, mbajti kumtesën: “Probleme gjuhësore morfologjike të trajtuara nga Ndre Mjeda”.

Studiuesi i mjedologjisë Dr. Mentor Quku, që e mori fjalën më pas, kumtoi rreth përfundimeve të studimeve të tij mbi 40-

vjeçare mbi rolin e Mjedës si misionar i Rilindjes Kombëtare, jo vetëm në letërsinë shqipe, por edhe në fusha të tjera të jetës qytetare, shkencore, sociale. liturgjike, si pionier. Mjeda, solli në shoqërinë shqiptare konceptin mbi modernizimin e bujqësisë shqiptare, të fshatit si dhe të bujkut shqiptar. Këtë e arriti me pjesëmarrje aktive në punët bujqësore dhe ndërtimore. Qe pionier i arsimit kombëtar.

Punimet u përmyllën nga studiuesja e re Ma. Brikena Smajli, përfaqësuese e QSA, e cila mbajti ligjeratën interesante rreth një vështrimi krahasues në mes “La vida essueño”, të Calderon de la Barca, dhe poemës “Andrra e jetës”, të Ndre Mjedës.

Nga ana e tjetër, mësohet se organizatorët e tubimit përkujtimit, kanë marrë përsipër të botojnë gjithë studimet e mbajtura në konferencë, në një vëllim të vetëm, duke realizuar kështu aktin e parë të veprimtarisë së Qendrës Muzeore “Ndre Mjeda”.

Përmylljen e punimeve të konferencës e bëri Prof. Ardian Marashi, i cili, tha se po krijohet një traditë e mirë e mbajtjes, një herë në vit, e ditëve të Mjedës.

Përurohet Qendra Muzeore “Ndre Mjeda” dhe shtatorja e poetit në Kukel

Veprimtaritë përruese u zhvilluan në Kukel, brenda ditës 1 gusht 2012. I gjithë kompleksi ishte zbukuruar me flamuj kombëtarë dhe afishe të shkruara për rastin përkujtimit.

Që heret ishin mbledhur për të marrë pjesë shumë banorë të Kuklit dhe të zonave përreth. Të pranishëm ishin edhe shumë studiues dhe personalitete, deputetë dhe intelektualë të shquar nga: Tiranë, Shkodra, Lezha, Malësia e Madhe, Ulqini, Kosova, Shkupi, Tetova, Presheva, emigracioni shqiptar në SHBA, Norvegji, Suedi, Gjermani, Itali etj.

Aktivitetet filluan me ceremoninë e bekimit të Qendrës Muzeore “Ndre Mjeda” nga Kryepeshkvi Metropolitan i Shkodrës, Imzot Angelo Massafra. Më pas u zhvillua ceremonia e prerjes së shiritit të Qendrës nga

Arqipeshkvi i Shkodrës Shkëlqësia e Tij Imzot Angelo Massafra, Ardian Marashi dhe Zef Hila.

Sipas traditës, u bënë vizita në ambjetet e Kishës së Shën Shtjefnit të restauruar e kthyer në origjinë, si edhe të shtëpisë së Mjedës, aty pranë, e cila pret edhe ajo të restaurohet në një fazë të dytë, në të ardhmen.

Në hyrje të shtëpisë së Mjedës ishte hapur ekspozita e librave të botuara nga Mjeda, kurse në brendësi të saj u vizitua një ekspozitë me fotografi të jetës dhe veprës së poetit. Binte në sy mungesa e tryezës së Mjedës, relike që ishte pritur nga opinioni publik shqiptar më të madhe por që ishte penguar për të zënë vendin e vet për shkaqe burokratike, të cilat nuk mungojnë në këto raste në Shqipëri. Në sinkron me këtë mungesë të qëllimshme ra në sy edhe mungesa e personaliteteve dhe autoriteteve qeveritare.

Në fjalën e hapjes së veprimtarisë përkujtimore dhe përruese, Drejtori i “Qendrës Muzeore “Ndre Mjeda”, si edhe famullitar i Kuklit, studiuesi Dom Dr. Nikë Ukgjini, tha: “Përrimi i kësaj Qendre po shoqërohet me rikthimin e këtij rilindësi të Madh në formë shtatore, në vendin që i takon, në Qendrën Muzeore, ku jetoi dhe krijoi kryeveprat e tija jetësore. E ku ka rast më të mirë që kjo të ndodhë me 1 gusht të këtij viti jubilar, në Ditët e veprimtarisë përkujtimore kushtuar poetit? Vepra është realizuar nga skulptori i talentuar, Sadik Spahiu, i cili me shumë flijime pa pritur shpërbllim, i la vetes dhe kombit një vepër monumentale, shtatoren e poetit Mjeda. Puna e tij u kurorëzua më derdhjen në bronz të shtatores nga fonderia private e VlladimirLlakaj. E gjithë kjo vepër e pavdekshme, u financua, jo nga ata që kishin si detyrim, por nga aktivisti i shquar pukjani në mërgim, Zef Balaj nga NewYork-u. Objekti tashmë Monument Kulture, i cili, rrezaton, para jush në mënyre të shkëlqyer, u arrit të rikthehej në identitetin e tij të mëparshme, më angazhimin e arkitekti Zef Çuni dhe ekipit të tij, të udhëhequr nga Nikolin Marku. Ndërsa, financimet u mundësuan nga Kryepeshkvi i

Shkodrës, Imzot Angelo Massafra, të disa biznesmenëve nga Shkodra në krye më Gjergj Leqejzen, mërgimtarin në Itali, Tonin Musa, komunitetin “Zoja e Shkodrës”, nga NewYorku në krye me Dom Pjeter Popaj, si dhe komunës së Bushatit në territorin e se cilës gjendet Qendra Muzeore Ndre Mjeda”.

Një çast solemn erdhi kur u zhvillua ceremonia e përvënimit të shtatorës së bronxit të poetit. Shtatorja e mbështjellë me flamurin kombëtar u zbulua nga Dom Dr. Nikë Ukgjini, Arqipeshkvi Imzot Angjelo Massafra, Ardian Marashi. Fjalën e rastit e mbajti Drejtori i QSA Prof. Ardian Marashi. Kryetari i Konferencës Ipeshkvnore të Shqiperisë Imzot Massafra, mbajti fjalën përshëndetëse, ku theksoi, se: “Dom Ndre Mjeda, duke u nisur nga parimet universale të shpallura nga Bibla, i frymëzuar dhe nga paraardhësit e tij, Budi, Bardhi, Bogdani, për 30 vite me radhe në Kukel, vazhdoi të krijoj vepra të mrekullueshme, të përmasave kombëtare dhe ndërkombëtare, me gjurmë hyjnore dhe njerëzore, të kapshme dhe të kuptueshme, nga të gjithë, për të mirën dhe emancipimin e shoqërisë shqiptare, prandaj, edhe shqiptari i sotëm bashkëkohor, për ta pasur në jetën e përditshme me te paqësueshme dhe me te suksesshme, duhet të synoj dhe të perceptoj vlerat universale dhe ato fetare e kombëtare të transmetuara nga mendja e mbretë të poetit Mjeda. Duke qenë se jemi në vitin Jubilar të 100 vjetorit të Shtetit Shqiptar, nisur nga ky fakt, Konferenca Ipeshkvore e Shqipërisë, në emër të cilës jam duke folur, në Letrën Baritore, “Fides et Patria” (Fe e Atdhe), dt. 3 maj 2012, thekson se, veprimi i Zotit në historinë e shëlbimit duhet të bëhet shprehje e një projekti të madh edukativ fetare e kulturor, i orientuar drejtë një shtegu të ri që shpie në mirësi, dashuri dhe në respekt ndaj vlerës së madhe që ka jeta e secilit njeri e sidomos atij të

Vitit Jubilar. Duke qenë i bindur se kjo Qendër e porsa përvënuar do luaj një rol të rëndësishme në përhapjen e paqes, mirëkuptimit, studimit të vlerave të poetit Mjeda, shprehi përgëzimet e mija të singerta, duke i dëshiruar, punë të mbar dhe të suksesshme në promovimin e vlerave fetare dhe kulturore”.

Veprimtaria përkujtimore vazhdoi me ceremonitë e tjera të planifikuara, si shpallja e fituesit të çmimit vjetor “Ndre Mjeda” për vitin 2012.

Drejtori i QSA Ardian Marashi, ia dorëzoi çmimin skulptorit Sadik Spahia, i cili, duke marrë medaljen, tha se shtatorja u realizua nga dëshira dhe vullneti i mirë i donatorit bujar Zef Bala.

Në vazhdim të veprimtarive, Dom Nikë Ukgjini, i dorëzoi arkitekt Zef Cunit diplomën për ndihmën e madhe, që ka dhënë në rindërtimin dhe kthimin në identitet të Kishës së Shën Shtjefnit dhe mjediseve të Qendrës Muzeore.



Më pas erdhi fjala përshëndetëse e piktorit Astrit Tota, i ardhur nga NewYork-u, i cili, lexoi letrën përshëndetëse të zotit Tomë Mrijaj.

Piktori Tota, në mesazhin përshëndetës të Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Prizrenit, Tomë Mrijaj, i cili për arsye madhore nuk ishte i pranishëm në këtë seance, tha: “Afrimi i ngjarjes jubilarë të 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë po përkon me

rikthimin e dijetarit, poetit, atdhetarit të shquar dhe gjuhëtarit të madh Dom Ndre Mjedës në Panteonin e krenarisë të njerëzve të shquar të kombit tonë. Ka shumë kohë që në New York bashkëatdhetarët tanë pranë Kishës “Zoja e Shkodrës”, përmes famullitarit të nderur Don Pjetër Popaj si gjithnjë i janë përgjigjur pozitivisht fushatës për mbledhjen e fondeve për realizimin e nismës së famullitarit të Kuklit, Don Dr. Nikë Ukgjini dhe Prof. Mentor Qukut, për ngritjen e Qendrës Muzeore “Ndre Mjeda”, në vendin ku jetoi dhe krijoi kryeveprat e tij dhe të tërë letërsisë shqipe. Qysh në fillim kam qenë në kontakt me dy njerëz të palodhur studiuesin skrupuloz të mjedologjisë Prof. Mentor Quku dhe studiuesin dhe klerikun përparimtarë fort të nderuarin Don Dr. Nikë Ukgjini që gjithnjë kanë menduar për realizimin e projektit që nga letra sot është kthyer në një kompleks real funksional, që do ta kishin zili edhe institucionet e specializuara kulturore shtetërore. Ndjej kënaqësi sot, kur shoh bashkë me ju bashkëatdhetarë realizimin e programit ambicioz për kthimin në identitet të qendrës muzeore “Ndre Mjeda”, apo tek shohim rindërtimin e Kishës së Shën Shtjefnit të Kuklit, si edhe mjedisi përreth. Krenari ndejmë sot tek rishohim mbas shumë dekadash Don Ndre Mjeden tek bisedon me ne kur na sheh sot të mbledhur për nder të tij nga shtatorja e derdhur mjeshtërisht në bronz, e cila, u bë realitet falë bujarisë së aktivistit të shquar të çështjes atdhetare biznesmenit të suksesshëm shqiptaro-amerikan, zotit Zef Balaj. Për fat të mirë, kemi një koncidencë, sepse sponsori i shtatores vjen nga i njëjti vend më poetin e bylbylit Mjedën e madh. Kushdo që ndodhet sot përpara këtij kolosi të madh të kombit tonë, e di se Don Ndre Mjeda ishte rilindësi, që tërë jetën rrezatoi idetë e tij përparimtare, për të cilat u arrestua e u burgos dy herë nga osmanlinjtë, dy herë nga shteti shqiptar dhe një herë nga serbët. Kudo që shkoi me shërbime fetare e atdhetare, ai u mor me veprimtari përparimtare praktike ambientaliste dhe ndërtuese, me vepra bonifikuese, rrugë, pyje, solli makineri

bujqësore, farëra të zgjedhura dhe plehëra kimike. Kukli apo trojet shqiptare dhe Mjeda ishin sinonim të njëra tjetrës. Edhe një herë e gëzofshi kompleksin kulturorë dhe fetar, muzen, Kishën e rindërtuar dhe bustin e poetit tonë, që tashmë do të jetojnë me ne, duke qenë dëshmitar i përparimit, që po pëson krahina e Kuklit dhe trojet tona në vitet e demokracisë, për të cilin pat folur dhe shkruar edhe Mjeda ynë”.

Aktiviteti u përmyll me një program të ngjeshur artistik, me artistë të ardhur nga Shkodra, Prishtina, si edhe me grupe nga nxënësit e shkollave të zonës së Bushatit dhe Mirditës.

Studiuesi i mirënjohur, Mentor Quku, dorëzoi diplomën e recitueses më të mirë, kurse kryetari i Komunës së Bushatit, Zef Hila i dorëzoi studiuesit të palodhur Dom Nikë Ukgjinit diplomën për kontributet e veçanta në ringritjen e Qendrës Muzeore.

Programi, i cili, u moderua me profesionalizëm nga gazetari televiziv Gjergj Marku u mbyll me premtimin se veprimtaria “Në kujtim të Mjedës”, do të organizohet në mënyrë periodike për çdo vit.

Ndërkohë mësohet, se kanë lindur projekte, për krijimin e një grupi pune për të vendosur ikonografinë e Kishës së Shën Shtjefnit, për ndërtimin e varrit të Mjedës brenda kompleksit, duke përmbushur kështu një amanet të Mjedës për t'a varrosur në Kukel, në themelet e Kishës.

Gjithashtu një projekt tjetër është, që brenda dhomave të shumta të Shtëpisë së Mjedës të ngrihen: “Dhoma etnografike”, me kostume kombëtare të zones; “Shtëpia e poezisë”, ku, të mblidhen e të kontaktojnë poetë nga vende të ndryshme; “Dhoma e Arkivit”; “Biblioteka e Mjedës”; “Qendra e studimeve mjedologjike”, etj. Këto ditë piktori i mirënjohur Maks Velo, i dhuroi Qendrën Muzeore të Kishës së Kukelit një piktur përkushtuar Dom Ndre Mjedës.

*Marrë nga gazeta: Dielli,
(Boston- New York) 15 gusht 2012.*

DOM NDRE MJEDA FRYMËZUAR NGA PARIMET UNIVERSALE

“DITËT E MJEDËS” - Kukël, 1 gushte 2012

Fjala përshëndetëse Imzot Angelo Massafra

Të nderuara Autoritet Shtetërore dhe Lokale, studiues, te dashur besimtare dhe miq. Ju përshëndes me fjalët e Jezusit të Ngjallur, Paqja me Ju.

Në fillim falënderoj Dom Nikën, famullitar, bamirësitë, të cilët na kanë ndihmuar për restaurimin e kishës dhe e këtyre ambienteve përreth kishës, të kushtuar Shën Shtjefnit, Martir i parë i Krishterimit. Përshëndes Meshtarët, Murgeshat dhe besimtarët e kësaj famullie.

Ndodhemi në këtë vend, të bashkuar, për ta përkujtuar, meshtarin, dijetarin, poetin, shkrimtarin, humanistin, pajtuesin, Dom Ndre Mjeda, i cili për 30 vite me radhë, ne këtë

famulli dhe në vendet për rreth, kreu denjësisht shërbimet Hyjnore, duke i gërshetuar ato me angazhimet e tija, kulturore, humane dhe atdhetare. Jemi këtu edhe për të bekuar statujën e tij dhe punimet e bëra.

Falënderoj të gjithë organizatorët e kësaj dite.

Dom Ndre Mjeda, si dhe vëllai i tij, Imzot Lazer Mjeda, kryepeshkv i Shkupit dhe nga vitit 1922-1936 i Shkodrës, si dhe bashkoheshit të tyre, Imzot Vinçenc Prennushi, Dom Lazer Shantoja, Dom Ndre Zadeja, Atë Gjergj Fishta, Atë Anton Harapi, Atë Anton Zanoni, Nënkyetar i Qeverisë së Vlorës, dom Nikollë Kaçorri, si dhe shumë klerik të tjerë, falë



frymëzimi të marr nga Fjala e Zotit, nga Bibla, gjatë misionit të tyre tokësor kanë transmetuar vlera hyjnore, krishtere, etike, morale dhe emancipuese, për krijim dhe mirëvajtjen e shtetit shqiptar.

Bibla, nga greqishtja „biblia“ që do të thotë „Libra“, është libri me i vjetër në botë, për të cilën iluministi francez i shek. XVIII, Zhan Zhak Ruso (Jean-Jacques Rousseau, 1712-1778) thoshte se është „libër i të gjitha kohërave“, përshkon të gjitha epokat historike duke bërë me to një dialog të përjetshëm. Ajo ka brenda të gjitha gjinitë, që nga poema, orakulli, rrëfimi historik, lutja, dialogu dhe ka me tepër së njëmijë personazhe. Si i tillë të gjitha kulturat e të gjithë njerëzimit e kanë zanafillën e vet në nga ky libër i Shenjt.

Historia e kontakteve të paraardhësve të shqiptarëve me Biblën, nisin në një farë mënyre me Shën Jeronimin nga Stridoni i Ilirisë, shekulli i V më përktimin e tij në gjuhën latine. Në shekujt e më pastaj më, në vitin 1468, kemi formulën e pagëzimit, kurse më 1555-, Gjon Buzuku, botoi librin e parë në shqip. Nisma e Buzukut u pasua në shekujt e më pastaj më nga përktime të tjera të shkrimeve të shenjt në shqip nga klerikët e Prelatët: P. Budi, F. Bardhi, P. Bogdani, Kostandin Kristoforidhi, Imzot Fan Noli, e deri tek dom Ndre Mjeda, dhe i fundit Dom Simon Filipaj. Përpjekjet e para për të përktyer këtë libër të shenjt në gjuhën e ndaluar shqipe, shënojnë dhe fillesat e shkrimit dhe zhvillimit të letërsi sonë ne gjuhen shqipe.

Dom Ndre Mjeda, duke u nisur nga parimet universale të shpallura nga Bibla, i frymëzuar dhe nga paraardhësit e tij, Budi, Bardhi, Bogdani, për 30 vite me radhe në Kukël, vazhdoj të krijoj vepra të mrekullueshme, të përmasave kombëtare dhe

ndërkombëtare, me gjurmë hyjnore dhe njerëzore, të kapshme dhe të kuptueshme, nga të gjithë, për të mirën dhe emancipimin e shoqërisë shqiptare. Le të kujtojmë vjershat me përmbajtje biblike që janë si katekizëm. Besimtarët mësonin të vërteta e fesë duke mësuar dhe duke kënduar këto vjersha. Dhe unë, në punë time baritore, insistoj shumë që meshtarët dhe Murgeshat të mos humbasim këto tradita: duke kënduar këto vjersha fetare çdo te diele.

Prandaj, edhe shqiptari i sotëm bashkëkohor, për ta pasur në jetën e përditshme më të paqësueshme dhe më të suksesshme, duhet të synoj dhe të perceptoj vlerat universale dhe ato fetare e kombëtare të transmetuara nga mendja e mbrehtë të poetit Dom Mjeda.

Duke qenë se jemi në vitin Jubilar të 100 vjetorit të Shtetit Shqiptar, nisur nga ky fakt, Konferenca Ipeshkvore e Shqipërisë, në emër te cilës jam duke folur, në Letrën Baritore, „Fides et Patria“ (Fe e Atdhe), dt. 3 maj 2012, thekson se, veprimi i Zotit në historinë e shëlbimit duhet të bëhet shprehje e një projekti të madh edukativ fetare e kulturor, i orientuar drejtë një shtegu të ri që shpie në mirësi, dashuri dhe në respekt ndaj vlerës së madhe që ka jeta e secilit njeri e sidomos atij të Vitit Jubilar.

Duke qenë i bindur se kjo Qendër e posa përruar do luaj një rol të rëndësishme në përhapjen e paqes, mirëkuptimit, studimit të vlerave të Dom Mjedës, shprehi përgëzimet e mija te singerta, duke i dëshiruar punë të mbar dhe të suksese në promovimin e vlerave fetare dhe kulturore.

E gëzofshim Qendrën Muzeore Dom Ndre Mjeda.



Ndre Mjeda, për Zot, Atme e Përparim

Fjala përshëndetëse e Dom Nikë Ukgjini
 “Ditët e Mjedës”, Kukël, 1 gusht 2012.

I nderuar Imzot Massafra, të nderuara autoritete shtetërore, që nuk gjetët kohë të vini, të nderuara autoritete lokale, të dashur studiues dhe miq të kulturës shqiptare nga brenda dhe jashtë atdheut.

Ndie kënaqësi të madhe, që sot kam rastin tu shpreh mirëseardhjen në këtë ditë të shënjuar, për të gjithë ne, për kulturën dhe kombin shqiptar në përgjithësi.

Pas një procesi pune, maj - qershor vitit të kaluar dhe prill – korrik të këtij viti, se fundi u arrit, që Qendra e projektuar dhe ndërtuar nga poeti i të gjitha kohërave Ndre Mjeda, të përurohet në praninë e tuaj, me rastin e 75 vjetorit të vdekjes dhe 100 vjetorit të Shtetit Shqiptar, të cilit ia kushtoj tërë jetën poeti Mjeda.

Nuk dua të flas për Mjedën, sepse, për jetën edhe veprën e tij, në mënyrë të mrekullueshme ka folur studiuesi, Mentor Quku, nëpërmjet 10 vëllimeve të botuara për këtë vigan të letrave shqipe, por, të rikujtoja, se Mjeda ishte rilindësi që tërë jetën rrezatoi idetë të përparuara evropiane. Kudo që shkoi, ai u mor me veprimtari, klerikale, gjuhësore, letrare, diplomatike, politike etj., duke ndriçuar faqe të historisë së lavdishme të popullit shqiptar në shekuj. Tërë jetën punoi për krijimin e një epepeje të bashkimit kombëtar, për pavarësi dhe ndërtimin e shtetit e të së drejtës. Punoi sipas, sloganit të Kolegjit Saverijan të Shkodrës, për Zot, Atme e Përparim, duke e shkruar tërë jetën tij tokësore në funksion të këtij qëllimi.

Përimi i kësaj Qendre po shoqërohet me rikthimin e këtij rilindësi të Madh në formë shtatore, në vendin që i takon, në Qendrën Muzeore, ku jetoj dhe krijoj kryeveprat e tija jetësore. E ku ka rast më të mirë që kjo të ndodhë me 1 gusht të këtij viti jubilar, në Ditët e veprimtarisë përkujtimore kushtuar poetit? Vepra është realizuar nga skulptori i talentuar, Sadik Spahiu, i cili me shumë flijime pa prituri shpërblim, la vetes dhe kombit një vepër monumentale, shtatoren e poetit Mjeda. Puna e tij u kurorëzua më derdhjen në bronz të shtatores nga fonderia private e Vlladimir Llakaj. E gjithë kjo vepër e pa vdekshme, u financua, jo nga ata që kishin si detyrim, por nga aktivisti i shquar pukjani në mërgim, Zef Balaj nga New Yorku.

Objekti tashme Monument Kulture, i cili

rrezaton, para jush në mënyrë të shkëlqyer, u arrit të rikthehej në identitetin e tij të mëparshme, më angazhimin e arkitekti Zef Çuni dhe ekipit të tij të udhëhequr nga Nikolin Marku. Ndërsa, financimet u mundësuan nga Kryepeshkvi i Shkodrës, Imzot Angelo Massafra, të disa biznesmenëve nga Shkodra në krye më Gjergj Leqejzen, mërgimtarin në Itali, Tonin Musa, komunitetin “Zoja e Shkodrës”, nga New Yorku në krye me Dom Pjeter Popaj, si dhe komunës së Bushatit në territorin e se cilës gjendet Qendra Muzeore Ndre Mjeda. Përkrahje këshilluese, ka dhënë dhe Drejtoria e Monumenteve të Kulturës më qendër në Shkodër. (Emrat e të gjithë ndihmuesve janë të afishuara në stende, në muret e shtëpisë muze).

Të dashur pjesëmarrës

Qendra synon të rritet dhe të zhvillohet. Ajo pritet të jetë, në mbrojtje të plot të dikastereve shtetërore. Pritet, gjithashtu që se shpejti të restaurohet shtëpia muze e cila si e tillë ka funksionuar në kohën e monizmit, me shkëputje në vitet 1963-1990. Në të do sistemohen gjërat personale të Mjedës: si materiale fotografike, shkrime studimore, botime librash, tryeza 100 vjeçare e cila akoma gjendet duke u shkatërruar depozitë muzeut të Shkodrës, etj. Qendra, pos që do jetë një vend pelegrinazhi kulturorë mbarëkombëtar, do luan rolin e një vatre të studimeve mjedologjike për brezat e rinj. Në këtë hapësirë do këtë vend edhe për vepra të krijuesve të rinj të cilët dëshirojnë të shfaqin talentin e tyre artistik në shumë drejtime. Qendra muzeore Ndre Mjeda, pos gjithë, do këtë dhe një varr të poetit, goftë dhe të improvizuar deri sa do gjenden eshtrat e tij, të cilat u zhduken pas viteve 1990, për të pasur mundësin, për ti bërë homazhin e duhur brezat që vijnë pas.

Objekti të cilin po e përurojmë duhet të trajtohet si i veçantë, sepse ruhet një kujtesë 100 vjeçare e Mjedës, në fushën e poezisë, gjuhës, letërsisë, diplomacisë, politikës dhe shumë fushave të tjera më të cilën është marr Ndre Mjeda. Kjo vepër me magjinë e saj, do rizgjon kujtesën historike dhe do nxis mendjen e brezave të rinj, që ta duan shkencën, kulturën, humanizmin dhe atdheun e tyre.

Zoti na goftë mbrojtësi dhe ndihma e jonë.

E GËZOFSHI KISHËN E RINDËRTUAR DHE BUSTIN E POETIT TONË

*Letra përshëndetëse e Tomë Mrijaj,
në emër të bashkatdhetarëve nga New Yorku dhe donatorit të shtatores, Zef Balaj*

Të nderuar zonja dhe zotërinj!
Të nderuar klerikë!
Të nderuar organizatorët e tubimit
përkushtuar burrit të madh Ndre Mjeda.

Afrimi i ngjarjes jubilarë të 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë po përkon me rikthimin e dijetarit, poetit, atdhetarit të shquar dhe gjuhëtarit të madh Dom Ndre Mjedës në panteonin e krenarisë të njerëzve të shquar të kombit tonë.

Ka shumë kohë që në New York bashkatdhetarët tanë pranë Kishës “Zoja e Shkodrës”, përmes famullitarit të nderur Don Pjetër Popaj si gjithnjë i janë përgjigjur pozitivisht fushatës për mbledhjen e fondeve për realizimin e nismës së famullitarit të Kuklit, Dom Dr. Nikë Ukgjini dhe Prof. Mentor Qukut, për ngritjen e Qendrës Muzeore “Ndre Mjeda”, në vendin ku jetoj dhe krijoi kryeveprat e tij dhe të tërë letërsisë shqipe.

Qysh në fillim kam qenë në kontakt me dy njerëz të palodhur studiuesin skrupuloz të mjedologjisë Prof. Mentor Quku dhe studiuesin dhe klerikun përparimtarë fort të nderuarin Don Dr. Nikë Ukgjini që gjithnjë kanë menduar për realizimin e projektit që nga letra sot është kthyer në një kompleks real funksional, që do ta kishin zili edhe institucionet e specializuara kulturore shtetërore.

Ndjej kënaqësi sot, kur shoh bashkë me ju bashkatdhetarë realizimin e programit ambicioz për kthimin në identitet të qendrës muzeore “Ndre Mjeda”, apo tek shohim rindërtimin e Kishës së Shën Shtjefnit të Kuklit, si edhe mjedisi përreth. Krenari ndjejmë sot tek rishohim mbas shumë dekadash Don Ndre Mjeden tek bisedon me ne kur na sheh sot të mbledhur për nder të tij

nga shtatorja e derdhur mjeshtërisht në bronz, e cila, u bë realitet falë bujarisë së aktivistit të shquar të çështjes atdhetarë biznesmenit të suksesshëm shqiptaro-amerikanë zotit Zef Balaj. Për fat të mirë, kemi një koincidencë, sepse sponsori i bustit vjen nga i njëjti vend më poetin e bylbylit Mjedën e madh.

Kushdo që ndodhet sot përpara këtij kolosi të madh të kombit tonë, e di se Don Ndre Mjeda ishte rilindësi, që tërë jetën rrezatoi idetë e tij përparimtare, për të cilat u arrestua e u burgos dy herë nga osmanlinjtë, dy herë nga shteti shqiptar dhe një herë nga serbët. Kudo



që shkoi me shërbime fetare e atdhetare, ai u mor me veprimtari përparimtare praktike ambientaliste dhe ndërtuese, me vepra bonifikuese, rrugë, pyje, solli makineri bujqësore, farëra të zgjedhura dhe plehra kimike. Kukli apo trojet shqiptare dhe Mjeda ishin sinonim të njëra tjetrës.

Edhe një herë e gëzofshi kompleksin kulturorë dhe fetar, muzën, Kishën e rindërtuar dhe bustin e poetit tonë, që tashmë do të jetojnë me ne, duke qenë dëshmitar i përparimit, që po pëson krahina e Kuklit dhe trojet tona në vitet e demokracisë, për të cilin pat folur dhe shkruar edhe Mjeda ynë.

Ju faleminderit!

Ndue Dedaj

Rreshen


“BIBLA” E PSIKOLOGUT SHKOLLOR, TË JAPËSH DHE MARRËSH BESIM ME NXËNËSIT

Shërbimi psikologjik në shkollë, një risi e arsimit shqiptar

“Duke qenë një vend në tranzicion, nuk jemi mjedisuar ende me futjen e psikologut nëpër shkolla. Kjo ndodh ngaqë ne, nxënësit, kur nuk besojmë tek prindi apo shoku, si mund t'i besojmë një personi tjetër? Besimi është diçka fundamentale dhe nuk mund t'i dorëzohet çdo njeriu, prandaj shpeshherë preferojmë të mbyllemi në botën tonë adoleshente. Pyetja ime është: tek cili duhet të besojë një i ri, tek një i afërm, apo tek një i panjohur?”.

Ky shënim domethënës, shkëputur nga blloku i shënimeve si punonjës i shërbimit psikologjik të gjimnazit të Rrëshenit, i përket majit të 2008-s, që përkon me futjen zyrtarisht të këtij shërbimi në arsimin tonë, pas tre vjetësh pilotimi. Duket se në pak fjalë është përmbledhur gjithçka që ndodh me një nxënës, kur gjendet përballë një studioje në shkollën e tij, ku lexohet “Kabineti i shërbimit psikologjik”. Edhe pse kanë kaluar kaq vjet, problemi i (mos)besueshmërisë së nxënësit mbetet sërish, ndonëse jo si në fillimet. “Psikologu shkollor është një njeri që merret me nxënësit me probleme mendore”, mendohej nga shumë prej tyre, duke e parë veten jashtë rrezes së tij. Natyrisht që psikologët shkollorë e kanë kapur këtë ngërç që iu lidhte duart dhe janë përpjekur të shtrijnë urat e besimit dhe komunikimit me gjithë nxënësit, duke argumentuar se ky shërbim nuk është vetëm për disa fëmijë në nevojë, por një mundësi për këshillim për çdo nxënës. Ndaj secili psikolog ka një normë prej 1500-2000 nxënësish për të mbuluar në dy-tre shkolla. Atëherë, na u desh të flisnim jo vetëm me nxënësin që pyeste se kujt i duhej besuar më parë, një të afërmi, apo një të “panjohuri” si psikologu shkollor, duke i mëshuar idesë se besimi duhej dhënë e marrë në mënyrë të dyanshme, pasi njeriu që ndërhyr në problemin që ti ke është personi i duhur, si njeri konfidencial (që ruan fshehtësinë e asaj që kumtohet), i paanshëm, i specializuar dhe trajnuar për një barrë të tillë.

Shërbimi psikologjik ka filluar të japë frytet e veta në shumë shkolla të vendit, si të Tiranës, Beratit, Lezhës etj., kjo dhe falë disa psikologeve të



reja dinamike, që duket se janë më të shumtat e më të zellshmet në radhët e psikologëve shkollorë. Ato përherë e më mirë po dinë të depërtojnë në problematikat e nxehta social-psikologjike të adoleshencës etj. Mund të thuhet se është ky “grupim” psikologesh të diplomuara vitet e fundit, që me përvojën e vet, përmes vëzhgimeve, sondazheve, anketave, ndërhyrjeve, gjer manualeve të para të fushës, po e konfigurron këtë shërbim në Shqipëri brenda më pak se një dhjetëvjeçari. Por varet dhe sa e si

mbështetet ky shërbim mjaft i vlefshëm për shkollën. Drejtori i DAR Lezhë, zoti Kastriot Kodheli, gjatë një veprimtarie në Ditën Botërore Kundër Duhanit (31 maj), duke përshëndetur nxënësit dhe mësuesit e gjimnazit “Hydajet Lezha”, atij të Ishull-Lezhës, si dhe të shkollës së mesme profesionale “Kolin Gjoka”, ftoi në podium tri psikologët e reja, Majlinda Toma, Alma Shyti dhe Elona Deda, duke vlerësuar punën e tyre. “Takimin e parë si drejtor rajonal i arsimit e kam bërë pikërisht me psikologët shkollorë të rrethit”, u shpreh ai, duke shtuar se “cilësia e shërbimit psikologjik është dhe synimi ynë”.

E ardhmja është përherë një sfidë dhe psikologu shkollor sheh pikërisht atje, si do të sillen nesër në jetë “aktorët” e tij, që sot janë të vegjël. Ai këshillon, ndërhyr pa kushte, pa shpërblim, pa protokoll, ndonjëherë dhe pa faleminderit – dhe kjo është e mjaftueshme për kredencialet e tij në shkollë. Preokupimet e tij më së shumti janë:



shëndeti mendor, zhvillimi psikosocial i fëmijës, shkalla e motivimit të të nxënës, integrimi i fëmijëve me probleme sociale etj.

Psikologjia shkollore në botë nisi njëqind e njëzet vjet më parë

Për ecurinë e shërbimit psikologjik, si risi në arsimin shqiptar, nevojitet dhe një bazë teorike. Në jo pak botime me interes, renditet dhe një manual i UNICEF-it, botuar më 2006-n, ku trajtohen për herë të parë kërkesat e punës së një psikologu shkollor, baza ligjore e shërbimit psikologjik, konceptet dhe përcaktimet themelore, struktura, këshillimi, dokumentimi, referimi e nxënësve pranë shërbimeve psikologjike të specializuara etj. Kurse nga “Qendra e Zhvillimeve Humane” u botuan materiale në ndihmë të psikologëve shkollorë, krahas trajnimit të frytshëm që u krye gjatë vitit 2009 në të gjithë vendin nga pedagogë të Fakultetit të Shkencave Sociale të UT, si Theodhori Karaj, Adem Tamo etj. Në fokus ishin çështje të tilla si: vlerësimi i nevojave psikologjike, instrumentet për vlerësime psikologjike, këshillimi nga psikologu shkollor, ndërhyrja psikologjike në raste krizash, zhvillimi psikologjik i moshave shkollore, organizmi dhe menaxhimi i klasës, përfshirja e prindërve në edukim, menaxhimi i sjelljeve agresive, trajnimi i trajnerëve, shkolla si një institucion multidimensional etj. Dr. Edmond Rapti, i këtij Fakulteti, ka përgatitur dhe një cikël leksionesh të kursit “Psikologjia shkollore”, ku përvijohen hapat që ka hedhur kjo fushë e psikologjisë, relativisht e re dhe në botë. Autori shkruan se ndër përpjekjet e para ishte hapja nga Witmer e klinikës së parë psikologjike për fëmijët që kishin probleme në shkollë, në vitin 1892,

qëllimi i së cilës ishte kurimi i problematikave shkollore në shkollat publike.

Më 1900-n hapet nga Smedley laborator i psikofizik, ku psikologët nisen të bënin matje psikofizike të cilësive të ndryshme të sjelljes së nxënësit. Dy vjet më pas u hap nga Maximilian një institucion me emrin Byroja e Studimit të Fëmijëve, ku për herë të parë u mundësua përdorimi i testeve psikologjike, për matjen e shumë karakteristikave fizike e psikologjike të fëmijëve. Ky u quajt dhe psikologu i parë shkollor në botë. Në fillimet e shekullit të 20 u përzgjodhën njëzet shkolla në Çikago, si shkolla eksperimentale, për aplikimin e pyetësorëve të natyrës psikologjike etj. Në këto shkolla u fut shërbimi psikologjik, objekti fillestar i të cilit ishin fëmijët e braktisur. Ekipi i shërbimeve psikosociale përbëhej nga psikologu, mjeku, sociologu dhe punonjësi social.

Në vitet '30, Walter në platformën e tij të shërbimit psikologjik përcaktoi gjashtë funksione të psikologut shkollor. Pas viteve '30 nisi një lëvizje për përfshirjen e psikologut shkollor në çdo shkollë amerikane, ku i pari që e bëri këtë ishte shteti i Nju Jorkut. Fillimisht në këtë pozicion u vendosën mësues, që kishin zotësitë praktike, por jo dhe aftësimin teorik. Pati hapa të tjerë në modernizimin e këtij procesi, por objekti do të mbetej po ai: “zgjidhja e problemeve psikologjike që kanë nxënësit në shkollë”. (Shih: E. Rapti, “Psikologjia shkollore”, Tiranë 2011.) Botime të mirëpritura në këtë fushë janë: “Psikologjia e zhvillimit të fëmijës” nga Theodhori Karaj, “Etika e këshillimit” nga Milika Dharmo, “Stresi dhe menaxhimi i tij” nga Qazim Dushku, “Psikologjia shkollore e zbatuar” nga Jeta Toçila Shkurti etj., si dhe një varg librash me rëndësi të autorëve të huaj.

Shkolla në fokusin social-psikologjik

Psikologu shkollor është “autonom” në punën e tij. Ai e ndërton planin e veprimtarive në përputhje me nevojat që ka shkolla për shërbimet psikologjike bazë, nisur nga mjedisi social ku ajo gjendet, me nxënës nga qyteti, nga qyteti dhe nga fshati, apo vetëm nga fshati, prania ose jo e konviktorëve etj. Në shkollat e Mirditës, Elbasanit, Korçës e të tjerë ka pikërisht një përbërje të tillë të larmishme, çka nënkupton dhe forma pune që t'i përshtaten asaj. Thënë ndryshe, karakteristikat e

psikologjisë së zonës nuk mund të mos reflektohen në shkollë. Ashtu si ato të komuniteteve të caktuara sociale, si romë dhe egjiptianë. Ka vërtet një optikë të përgjithshme në veprimtarinë e psikologut shkollor, por ka dhe një kundrim të posaçëm ndaj kategorive femënore në nevojë, me shqetësime familjare, shëndetësore etj: fëmijë të sëmurë, jetimë, të braktisur, nga familje të varfra, që kanë përjetuar dhunë psikologjike, fizike, stres, depresion etj. Psikologu shkollor “kuron” te fëmijët vetminë, frikën, dilemat, menaxhimin e keq të kohës, eksperimentimin me drogën e alkoolin, ndonjë mendim rreh vetëvrasjes, shqetësimet rreth seksualitetit etj.

Nuk është aq e lehtë të përfytyrohet se nga e siguron lëndën e parë të punës së tij një psikolog shkollor, ngaqë nuk merr pjesë drejtpërdrejt në procesin mësimor, nuk hyn e del në klasa pesë herë në ditë si të tjerët, se nuk jep mësim etj. Po ashtu, ai nuk bën punë edukative, nuk prin nisma mësimore etj. Për më tepër që mësuesit tradicionalë, të pamësuar me këtë zanat të ri të shkollës, shpesh kanë prirjen ta anashkalojnë, në kuptimin që këto punë i dimë vetë etj. Por ata të dy, mësuesi dhe psikologu shkollor, sido që të jetë marrëdhënia e sotme, kanë mjaft udhë për të bërë bashkë në përditshmërinë e përbashkësinë shkollore, ku prapë secili ka atë udhëzën e tij: mësuesit i lipset rezultati i matshëm në programin mësimor: të letërsisë, matematikës, fizikës, kimisë, gjeografisë, teknologjisë së informacionit, edukimit fizik etj., kurse psikologut shkollor nuk i lipset asgjë e matshme, por diçka tejet specifike, siç është mirëqenia e nxënësit në këtë proces, mirëqenia shpirtërore dhe mendore, të qenët e tij i motivuar dhe i pastresuar në shkollë dhe jashtë saj. Syri i tij është mprehur për të parë ato fijet delikate si të padukshme që të tjerëve mund t’iu rrëshqasin. Anketat dhe pyetësorët për të zbuluar veçori e dukuri psikosociale janë mjete në duart e tij, po ashtu konsultat me aktorë të shkollës për qasje të ndryshme, si dhe bisedat, temat, debatet dhe diskutimet nëpër klasa ku psikologu shkollor merr pjesë. Raportet e punës së drejtorisë dhe analizat në këshillat e mësuesve etj. Takimet me prindërit. Sugjerimet e nxënësve që kërkojnë këshillim. Strategjitë kombëtare e rajonale për fëmijët etj.

Thuhet me të drejtë, se psikologu shkollor, jo për ndonjë status favorizues, por për shkak të

natyrës së profesionit specifik, duhet të bëjë që të tjerët t’i shkojnë “mbrapa”, mësuesit, nxënësit, prindërit, në kuptimin që ai të jetë vazhdimisht i kërkuar. Vetëm kështu ai mund të sigurojë ndihmës dhe bashkëpunëtorë për shërbimin psikologjik dhe të bëhet realisht i vlefshëm për komunitetin shkollor ku shërben.



Mësuesi, psikolog? Pse jo...

Tani që ky shërbim i specializuar po e mbulon shkollën përherë e më ndjeshëm, sa do të jetë i nevojshëm mësuesi në rolin e psikologut, për klasën e tij në kujdestari, apo lëndën e tij? A mos ai tani nuk e ka më këtë ngarkesë? Mendimi ynë është se mësuesi nuk është liruar aspak nga barra e të qenit psikolog i nxënësve dhe kjo për disa arsye:

E para, procesi mësimor është unik, i pandarë në aspektin pedagogjik dhe psikologjik. Askush nga mësimdhënësit nuk mund të thotë se po “bën” pedagogji në klasë dhe njëherësh jo dhe psikologji. Kjo dhe për vetë natyrën e të nxënës, ku dijet e reja do të merren përmes një metodike që mban parasysh dhe anët vetjake të nxënësit, temperamentin, karakterin, motivimin, vullnetin, ndrojtjen, stresin etj. Nuk mund të kesh sukses në procedimin mësimor, nëse nuk gjen mënyrat për ta tërhequr nxënësin në mësim, edhe kur ai ndihet i vetmuar, i mërziur, i pavullnetshëm etj.

E dyta, siç u cek dhe më sipër, ende nxënësit tanë nuk e pranojnë lirisht psikologun shkollor, duke e menduar atë si një person që merret me nxënësit që kanë probleme të shëndetit mendor etj. Është në natyrën e nxënësit të jetë më i hapur me mësuesin kujdestar, që është më pranë tij, e njeh më mirë dhe si i tillë është më i besueshëm. Po ashtu janë të rrallë ata prindër që mund t’i kërkojnë fëmijës së tyre të rrëfëhet te psikologu shkollor, kur

ata gjithçka ia besojnë mësuesit për sa i përket fëmijës, madje në zonat rurale shpesh duke i sugjeruar dhe “thuprën” për të. Aq më tepër në ciklin e ulët zor se mund të mendohet ndonjë rol i psikologut shkollor pa ndihmesën e mësueses, që ende në këtë moshë konsiderohet si një prind i dytë për nxënësin vogëlush.

E treta, vetë mësuesit thonë se gjatë procesit mësimor ne e vëzhgojmë nxënësin në disa detaje që kurrë nuk mund të kapen nga dikush që nuk është i përfshirë në këtë proces, orë pas ore e ditë pas dite, ndaj dhe puna e psikologut mbështetet pikërisht në ato rekomandime që merr nga mësuesi, veçanërisht ai kujdestar. Një mësues lënde sillte rastin e një djali maturant që ndihej i kompleksuar të përgjigjej në mësim, pasi përqeshej nga djemtë e tjerë të klasës, që nuk mësonin, duke zhvilluar me të disa kontakte këshilluese, që atij t'i zgjidhej gjuha e “lidhur” nga keqkomunikimi i bashkëmoshatarëve të tij. Një mësues kujdestar, pas këshillimit me psikologun shkollor, trajton me kujdes, për disa javë, rastin e një vajze të zhgënjyer nga një lidhje sentimentale e nxituar. E cili mësues nuk u mor me çështje të tilla delikate të nxënësve të tij?...

E katërta, vetë elementet strukturore të shërbimit psikologjik e kanë përfshirë mësuesin si anëtar i grupit mbështetës etj. Por ky grup ndihmës i shërbimit psikologjik, për të qenë i motivuar e realisht veprues, mund të lehtësohet nga ngarkesa mësimore, me dy apo tri orë mësimi, në shkolla me mbi pesëqind nxënës.

E pesta, ka disa mësues që janë më pranë profilit të psikologut, si i psikologjisë, i sociologjisë, i biologjisë, i edukimit fizik, apo dhe i informatikës etj. Nuk ka se si këta të trajtojnë aspekte të mësimdhënies që lidhen me fëmijët, vetëm në përgjithësi e teorikisht, pa pasur parasysh dhe terrenin ku veprojnë nxënësit e tyre. Mund të shkoqitet se cila mund të jetë qasja e çdonjërit nga këta mësues në raport me objektin për të cilin po flitet, ama dhe mësuesi në dukje më pa lidhje me psikologjinë, ai i informatikës, ka se ç'të bëjë në rolin e këshilluesit psikologjik, përderisa në nxënësit e tij ka një varësi përherë e më të madhe ndaj rrjeteve sociale.

Psikologët e njohur ngulmojnë se roli i mësuesit është i pazëvendësueshëm në të dyja rastet kur psikologu shkollor ofron shërbim psikologjik për nxënësit, drejtpërsëdrejti ose tërthorazi.

“Më fal, mësues Marku!”

Se sa thelbësor është bashkërendimi i psikologut shkollor me mësuesit dhe drejtorinë e shkollës, e tregojnë dhe disa episode në pamje të parë të thjeshta, po që lidhen me shqetësime të papërbalueshme të nxënësit dhe që nuk janë aq sporadike sa mund të duket. Një nxënës nuk e ka duruar opinionin mbytës të shokëve të tij, që e përqeshnin duke i përmendur të atin të sëmurë mendor, ndaj ka shkuar në Zyrën Arsimore për të kërkuar transferimin në një shkollë tjetër. Ky është një rast domethënës, se si një shoqëri e pa kultivuar nuk di të sillet me njerëzit në nevojë, shpesh duke shkaktuar shqetësime tek të afërmit e tyre, veçmas te fëmijët. Kjo është nganjëherë shoqëria jonë lara(hu)mane. Një nxënës i tillë nuk e braktis shkollën, paçka se befas ëndrra i është prishur. Mësuesit nuk kanë ditur a nuk kanë mundur t'i gjenden në krah që në vogëli, duke e lënë në brengën e vet.

Të vjen ndërmend një episod jetësor rrëfyer nga poeti i njohur Viktor Gjokolaj (Lezhë), nga Kurbneshi i fund viteve '60. Mësuesi i tij, Mark Arapi (kishte kryer studimet ushtarake në Modena të Italisë, po për shkak të rrethanave politike të pasluftës, e kishin larguar nga ushtria) kishte shfaqur bindjen për zotësitë jo të zakonshme të një nxënësi, nëse ai do të vazhdonte të shkollohej. Por fati i atij “gjeniut” kishte qenë tronditës, ai kthehet nga studimet e larta i sëmurë mendor, duke i ndërprerë ato. Një ditë në restorantin e minierës po bënte rrëmujë, si dhe herë të tjera, kur befas i kapi syri mësuesin e 7-vjeçares, dhe me hapa të ngadaltë shkoi drejt tavolinës së tij. U ndal, drejtoi trupin e rënduar nga sëmundja, vuri dorën në zemër dhe u përku, si para një hyjnie, duke shqiptuar me ton përgjërues: “Më fal, mësues Marku!”

Kjo ishte skena, që do ta kishte lakmi dhe Frojdi apo Jungu. Atë çast mësuesin “pedant” të atij viti të largët 1969 e kishte tradhtuar një lot. V. Gjokolaj, dikur i privuar nga shkollimi e tash i diplomuar për letërsi, kujton: “Mësues Marku i vëzhgonte tipat e ndryshëm për një kohë të gjatë dhe në pavarësi të plotë nxirrte përfundimet e duhura, që sipas rastit ua thoshte nxënësve apo prindërve. Kishte krijuar besim të madh te njerëzit. Para nesh nuk ishte thjesht mësuesi, por njeriu i ditur, mendimtari, psikologu i pagabueshëm në

gjykimet e tij. Ai i ndërtonte marrëdhëniet me nxënësit e prindërit duke njohur nivelin dhe mendësitë e tyre, problemet familjare etj. Psikologjia popullore e vështron personalitetin njerëzor me thjeshtësi e thellësi të çuditshme. Nuk thonë kot për një fëmijë të mangët: “Asht prej familje soj, por ka rreshqit...”

Paçka ndryshimeve të sotme social-kulturore e arsimore, mësuesi prapë nuk ka dalë nga roli prej psikologu këshillimi. Ashtu si mësues Marku dikur dhe klasa e tij e arsimtarëve. Vërtet sot ka specialistë (klinistë, terapistë) që merren me kurimin e çrregullimeve të personalitetit, depresionit, devijancave etj., ama mësuesi është “terapisti” i së përditshmes, poseduesi i laboratorit më të larmishëm të sjelljeve njerëzore, që është shkolla dhe oborri i saj. Gjatë semestrit të parë të vitit shkollor, IKAP-i ka ushtruar kontrole dhe bërë vlerësime në disa shkolla të vendit, mbi cilësinë e shërbimeve të ofruara, pra dhe atij psikologjik, duke e parë atë të lidhur ngushtë dhe më pozitën e mësuesit. Ky shërbim tashmë funksionon, por “kushtet dhe mjedisi i punës së psikologut shkollor kanë nevojë për përmirësim, si në sigurimin e mjedisit vetjak të punës, ashtu dhe në cilësinë e këshillimit që psikologët shkollorë ofrojnë.” (“Mësuesi”, 2 shkurt 2012). E në gjithë këtë “maratonë” përkujdesi dhe trajtimi social-psikologjik të nxënësve, mësuesi gjithsesi është i përfshirë, ashtu si dhe drejtuesit e shkollave dhe ZA-ve. Ndërkohë që do të duhet shumë punë që dhe prindi t’i qaset shkollës me tjetër receptim, atë të bashkëpunuesit dhe jo të llogari kërkuesit tradicional.

Prindi, bashkëpunues i psikologut shkollor? E vështirë...

Në një nga ditët e fundit të vitit shkollor, një prind, që mezi e fshihte zemërimin, kishte shkuar në shkollë të “njihej” me mësuesin kujdestar të djalit të tij... mbetës! Po të mos ishte katra në njërën nga lëndët, ai nuk do kishte begenisur të njihej ndonjëherë me mësuesin bashkëqytetas. Por vente për të bërë zakonin më të keq prindëror, atë të

grindjes me mësuesin, për notën e fëmijës. Nuk është ndonjë gjë e re të thuhet se shkolla nuk mund të bëjë përpara pa prindin. Madje duket e kaq lashtë kjo. Por praktika tek ne është dëshpëruese. Edhe



pse kanë ndodhur ndryshime sociale, kulturore dhe arsimore, duket se nuk e kemi gjetur fillin se si prindin ta bëjmë pjesë reale të shkollës. Ai është vite dritë larg rolit të tij bashkëpunues me shkollën, le pastaj me shërbimin psikologjik si diçka krejt speciale. Nuk është fjala për një dorë prindërisht bashkëpunues, por në tërësi rastet e komunikimit me prindërit e zonave rurale kanë qenë “kokëforta” nga ana e tyre; pak a shumë sipas logjikës “e dimë ne si bëjmë me fëmijën tonë”, si për ta mbajtur, si për ta larguar nga shkolla.

Psikologët vazhdimisht rreken ta përkufizojnë adolehencën, por duket se askush nuk mund ta bëjë këtë më mirë se vetë adolehencët, që janë vetvetja dhe duhen ndihmuar për të qenë të tillë. E për këtë, më së pari duhen kuptuar. Veçanërisht mësimdhënësit besojnë se i njohin, i kuptojnë, por në thelb vetëm ata (rinorët) e njohin thellësisht veten, ashtu siç janë, kurse të tjerët, mësuesit, prindërit, psikologët shkollorë, sociologët mund t’i njohin pak a shumë përmes vetë atyre, si të thuash me “lejen” e tyre. Kur i shohim 15-vjeçarët në oborrin e shkollës, në rresht, në klasë, shpesh i mendojmë thjesht, përciptazi, nuk e dimë sa janë të ndjeshëm, të zotë, pasi i masim me kutin tradicional të të madhit për të voglin, ndërkohë që ata janë shumë më shumë se i dimë ne. I ka bërë informacioni i jashtëzakonshëm që marrin,

veçanërisht ai virtual, dhe jo vetëm. Sidomos prindi e ka të vështirë këtë receptim të brezit të ri të sotëm, ndaj shpesh i qaset me stilin e vjetër.

Çfarë domethënie ka prania e prindërve (turmë) te porta e shkollës, ditën ku zhvillohet provimi i maturës shtetërore? Solidaritet me të birin, të bijën, në një ditë e “vështirë”? Zor të ketë ndonjë ndikim ndenja e mamit apo babait pas gardhit të shkollës, kur ai është në sallën e provimit dhe as që e sheh prindin e djersitur? Nuk është kjo, empirikja, formalja, rruga për t’iu gjendur fëmijës. Si prind, po të rrih më pranë mësuesve, psikologut shkollor, sociologut, të këshillohesh me ta, do të kuptosh disa gjëra jo dhe aq të dukshme por mjaft serioze, si abuzimet seksuale në adoleshencë, që më pas shoqërohen me trauma etj.

Sjella është mjaft e rëndësishme, pasi fundja ajo është gjithçka që bën njeriu. Në pamje të parë, sjellja e adoleshentëve ngjan alarmante, por nuk është kështu. Më saktë mund të thuhet se ajo është komplekse. Duhet lexuar dhe kuptuar moshë delikate me të gjitha dritëhijet e veta. Terry F. Pettijohn vëren se janë proceset biologjike ato që shpesh shoqërojnë sjelljen dhe njohjen. Po si mund ta kuptojë këtë prindi, kur ai në vend që të depërtojë në thelbin e gjërave, ende ka në majë të gjuhës atë frazën shabllone “kur ishin ne të rinj, ishim tjetër”.

Adoleshenti bën një kapërcim të madh nga fëmijëria në botën e të rriturit, ku Erikson formimin e identitetit e sheh si gjënë më themelore tek ai. Do të donim ta lidhnim këtë proces dhe me kultivimin e humanizmit te fëmijët. A po rrisim ne sot njerëz altruistë, bamirës, që sakrifikojnë për tjetrin? Apo shembujt për këto i marrim nga filmat e realizmit

socialist, apo tek ndonjë mësuese kineze heroinë që “shkurton” këmbët e saj për të shpëtuar një fëmijë nga rrotat e makinës. David G. Myers analizon altruizmin në parametrat e sotëm socialpsikologjikë; njerëzit jo rastësisht dhurojnë gjak, bëjnë punë vullnetare, ndihmojnë të sëmurët kronikë etj. E ku më shumë se në shoqërinë tonë me aq shumë trauma morale dhe sociale ka vend për altruizëm? Ndaj për shkollën, kjo është një temë e hapur.

Përmbyllje

Shtypi periodik, gazeta “Shqip” dhe posaçërisht suplementi “Ndryshe”, publikon herë pas here shkrime për arritje të psikologjisë botërore, por duket se ka mungesë të trajtesave, studimeve, raporteve nga vendi mbi dukuritë psikologjike. Në studio televizive shihen përherë e më shumë psikologë dhe sociologë që diskutojnë me kompetencë për mjaft dukuri të Shqipërisë së tranzicionit, por për psikologjinë shkollore ka vend të flitet më shumë.

Dhe ashtu siç e nisëm këtë shkrim me një adoleshent, po e mbyllim po me një adoleshent.

E pyetëm një djalë të shkollës 9-vjeçare, që mbahej si “lider” mes shokësh jo të rregullt, si dhe ku e shihte ai veten nesër kur të rritej. Dhe përgjigjja ishte e singertë: “nuk e di”. Ai ishte më i vërtetë se disa tipa që nxitonin të përgjigjeshin rutinë, që nga klasa e parë, unë do të bëhem mjek... inxhinier... jurist... piktor... stilist etj. Sepse ai nuk e dinte se ç’do të bëhej. Dhe jo vetëm ai. A duhej bërë diçka nga elita mësimore që ai të dinte, pak nga pak, sot e nesër, se çfarë do të “bëhej” kur të rritej? Natyrisht.

Ashtu si “kori” i klasës ku të gjithë do të bëheshin me profesione të “arta”, të kuptonte dhe ai se si mund të bëheshe jo vetëm inxhinier – po dhe mekanik, jo vetëm mjek – po dhe infermier, jo vetëm menaxher – po dhe hotelier etj.

Elita arsimore: mësues, drejtues, inspektorë, psikologë shkollorë, forume nxënësish, borde shkolle, komitete prindërisht, është e gjitha aty, duke dhënë e marrë përditë me edukimin, mësimdhënien, cilësinë. Por mundet jo përherë si një zë i përbashkuar bashkëkohor.



FATOS BAXHAKU
Tiranë

1910-1911: BARONI I KRYENGRITËSVE SHQIPTARË

Gjithçka u përshpejtua, kur një grup oficerësh dhe intelektualësh osmanë nisën të rebelohen ndaj gjendjes së pashpresë të Perandorisë Osmane, e cila në fund të shekullit XIX i ngjante një lëngate gjigante dhe gati-gati të pashpresë. Ata që u quajtën “xhonturqit” (nga frëngjishtja “lesjeunesturques”) shpresonin se duke kryer reforma modernizuese mund të ruheshin kufijtë e perandorisë kolosale. Partia në të cilën ata u mblodhën quhej “Itihatt ve Terakki” (Bashkim e Përparim). Dalja e tyre në skenën politike, në fillim në klandestinitet, krijoi një farë pështjellimi në qarqet politike shqiptare. Xhonturqit premtonin autonominë e qindra kombeve që përbënin asokohe Perandorinë Osmane, premtonin administratë me nëpunës vendas, bënin be e rufe se do të hapnin shkolla në gjuhën amtare. Jo keq në krahasim me dhunën që kishte ushtruar me shekuj me radhë sultanati. Kongresi i parë i xhonturqve u mbajt në Paris më 1902. Mosbesues ndaj tyre, “Njeriu i Pavarësisë”, Ismail Qemali, ndonëse i ftuar, refuzoi të merrte pjesë në të. Njësoj si Ismail Qemali ishin kundërshtarë të xhonturqve edhe Hasan Prishtina, Nexhip Draga, Shahin Kolonja e të tjerë. Në krahun në favor të turqve të rinj u rreshtuan disa figura po aq të njohura të politikës së shqiptarëve asokohe si Myfit bej Libohova, Syrja bej Vlora dhe Mit'hatFrashëri i famshëm.

Pikërisht në këtë atmosferë shqiptarët nisën të lëvizin. Hapat e parë kishin lidhje me arsimin. Në të gjithë vendin u ngritën klube patriotike që zakonisht quheshin “Bashkimi”. Për herë të parë në historinë shqiptare nisi botimi i gazetave në gjuhën shqipe në Shkodër, Manastir e Korçë. Në nëntor të 1908-s, përgjatë një jave në Manastir u zhvillua Kongresi i Alfabetit nën drejtimin e Mit'hat Frashërit, kreut të mëvonshëm të Ballit Kombëtar, të njohur edhe si Lumo këndo. Një vit më vonë u hap Normalja e Elbasanit me në krye Luigj Gurakuqin.

Në dhjetor të 1908-s u zhvilluan zgjedhjet parlamentare. Në krejt perandorinë fituan xhonturqit, porse deputetët që përfaqësonin trojet shqiptare ishin të krahut opozitar, ata drejtoheshin nga Ismail Qemali e Hasan Prishtina. Shpejt do të ndihej armiqësia e thellë mes shqiptarëve dhe xhonturqve, të cilët i harruan premtimet fatlume. Kundërshtive nacionale iu shtuan edhe ato politike.



Gjashtë muaj pas zgjedhjeve, xhonturqit nisën valën e arrestimeve ndaj patriotëve shqiptarë. Vendi u rrethua nga një regjim policor. Kulmi arriti kur më 1910-n xhonturqit nisën një aksion të madh ushtarak me pretekstin “e grumbullimit të armëve”. Drejtimi i parë ishte kundër popullsisë luftarake të Kosovës. Në krye të korparmatës ndëshkimore ishte Shefqet Turgut Pasha, i njohur për egërsinë e tij. Shqiptarët nuk i dorëzuan armët, përkundrazi i përdorën ato kundër osmanëve në dy beteja që bënë bujë në krejt botën e atëhershme. Në prill të 1910-s, në Kaçanik kryengritësit, nën drejtimin e Idriz Seferit, i gozhduan për dy ditë forcat osmane. Ishte një ndër betejat më të përgjakshme që kishte parë Europa e shekullit XX. Pak kohë më vonë, në Grykën e Caralevës, Isa Boletini dhe kosovarët që komandoheshin prej tij përsëriti të njëjtën gjë. Gjendja e vuri në alarm Stambollin. Në Kosovë mbërriti vetë Mahmut Shefqet Pasha, ministri osman i Luftës.

Pas fashitjes së kryengritjes së Kosovës, trupat e Shefqet Turgut Pashës kaluan në Malësitë e Veriut, mbi Shkodër. Me mijëra malësorë u strehuan në Mal të Zi.

Në fillim të prillit 1911, kralj Nikolla i Malit të

Zi thuajse i dëboi malësorët nga territoret e veta. Këta nën drejtimin e Dedë Gjo Lulit, nisën sërish kryengritjen antiosmane. Në qershor të 1911-s, në bjeshkët e Greçës, malësorët parashtruan kërkesat e tyre, thelbi i të cilave ishte autonomia administrative. Të dyja palët tashmë ishin lodhur nga një luftë e gjatë dhe e përgjakshme. Nën tryninë edhe të presionit ndërkombëtar Stambolli vendosi të bëjë disa lëshime: amnisti, rregullimi i shtëpive e kishave të djegura, nëpunës vendas. Në gusht 1911, në Podgoricë shqiptarët dhe xhonturqit pranuan paqen e brishtë.

Baroni “fluturues”

Pikërisht në këto kohë sillej këtyre anëve baroni austro-hungarez Francfon Nopça (1877-1933). Kishte lindur në Transilvani, në Rumaninë e sotme, porse ishte rritur në Budapest e Vjenë. Ky ishte një aristokrat i çuditshëm e kokëshkretë. Ishte gjeolog, paleontolog, etnolog, gjeograf, historian, hera-herës diplomat e ndërmjetës. Herë të tjera shfaqej ndër vende ku nuk njihej edhe si agjent i maskuar. Ishte gjithashtu një ndër kandidatët e vetëshpallur për fronin mbretëror të Shqipërisë. Baroni vdiq në rrethana tragjike në Pragë më 1933. Ishte homoseksual. Pasi vrau më parë sekretarin dhe më pas të dashurin e tij Bajazit Dodën, ia hoqi edhe vetes. Ishte prilli i 1933, baroni ishte 56 vjeç, në Pragë sapo trokiste pranvera. Nopça ka lënë pas një numër të madh studimesh e kujtimesh. Ndër 186 tituj që i atribuohen atij, 54 flasin vetëm për Shqipërinë e Veriut.

Kritikat ndaj Vjenës zyrtare

“Ndërsa kisha ndaluar në Shkodër, Turgut Shefqet Pasha po afrohej me ushtrinë e tij të Gjakovës, sipas shqiptarëve myslimanë për të çarmatosur katolikët”, shkruan Nopça më 1910. Ideja më e përhapur ndër ne është se Austro-Hungaria, konsujt e saj, ka qenë fuqia më në favor të kryengritjeve të shqiptarëve. Baroni na rrëfen një histori tjetër. Ai rrëfen se shumë herë malësorët shqiptarë u lanë në mëshirë të fatit. Në Shkodër Dedë Gjo Luli, prijësi kreshnik i malësorëve, i kërkon takim dhe i lutet “me lot në sy” që Vjena të ndërhyjë që malësorët të ruajnë armët e tyre, përndryshe e vetmja zgjidhje ishte kalimi te malazezët, armiqtë e tyre shekullorë dhe kundërshtarë të Austro-Hungarisë gjithashtu. Nopça vrapon te Zambaur, konsull i Vjenës në Shkodër. Porse gjen përgjigje negative. Më 1910 Austro-Hungaria zyrtare preferonte më shumë xhonturqit se sa shqiptarët e maleve. “Tani mirë,

shtyhet edhe ca kohë që t'i gënjesh njerëzit – i thotë konsulli baronit të mbetur me gojë hapur – por nuk e di sesi do t'ia bëj atëherë kur xhonturqit do të fillojnë t'i shtrojnë në dru!”.

Pak ditë më vonë baroni, i revoltuar ndaj njerëzve të tij, merr rrugën për në Vjenë. Këtu troket direkt në derën e zyrës së Ehrental, asokohe ministër i Jashtëm. Edhe këtu i njëjti qëndrim. “Për mua xhonturqit janë shumë më të vlefshëm sesa shqiptarët”, i thotë ministri, baronit teksa i kërkon që buxhetin që kishte marrë nga Vjena ta shpërndante si të mundte. Vjena nuk dëshironte madje as të pranonte se për disa kohë kishte ndihmuar me para malësorët shqiptarë kundër malazezëve. Baroni dorëzohet. I telegrafon të dashurit të tij, Bajazitit dhe i thotë t'i shpërndajë paratë si të mundet. “Bashkë me këtë detyrë e autorizova që të shajë sa të mundet në Shqipëri politikën e trashë të Ehrentalit”, shkruan baroni. Pas kësaj zhduket për disa kohë në Londër, për punë të tija.

Në çadrën e xhelatit

Nopça u rikthye nga Anglia në Shkodër në verën e 1911. Këtë herë vinte si korrespondent i gazetës “Fremdenblatt”. Miqtë e tij të vetëm kishin mbetur malësorët. Në Mal të Zi e urrenin, Vjena e quante një ngatërrestar të madh, ndërsa xhonturqit e shihnin gjithnjë e më me dyshim për miqësinë e tij të thellë me shqiptarët.

Takimin e parë në Shkodër baroni e bën me Halil beun, kryetarin e xhonturqve në qytet. “Po atë natë – shkruan ai – i paraqita budallallëkun e sjelljes së xhonturqve në formën më të ashpër dhe ia përsërita këtë ditën e nesërme edhe guvernatorit civil në të njëjtën mënyrë...”.

Një ditë më pas, baroni është në çadrën e famëkeqit Shefqet Turgut Pasha në Koplik. Shkon hipur mbi një kalë, me galop, i acaruar nga ato që po ndodhnin ndër malet përballë Shkodrës. “Në Koplik pata një bisedë të gjatë me Turgut Shefqet Pashën – kujtonte baroni – ky më shpalli se synonte shpartallimin e malësorëve dhe në vend të tyre, në kufirin turko-malazez, të sillte për t'u ngulitur emigrantë boshnjakë. Përveç kësaj, plani i qeverisë turke ishte që të shkombëtarizonte shqiptarët, pastaj t'u vërsulej shteteve sllavë të Ballkanit, në mënyrë që të asgjësoheshin njëri pas tjetrit... Kur gdhiu dita, që trupat do të marshonin kundër Shalës, herët në mëngjes u sula i xhindosur te përkthyesi i vilajetit dhe ia përplasa hapur të gjithë poshtërsinë dhe bërtita aq shumë sa dëgjohej dhe kuptohej edhe jashtë në rrugë. 'Epo, po ju them se ky është fundi i

Turqisë'. Këto ishin fjalët e fundit që i përplasa në surrat një nëpunësi turk në Turqi, para shpërthimit të Luftës Ballkanike". Ndërsa baroni protestonte, malësorët e lodhur, të uritur, të vetmuar e të gjakosur e kishin ndarë mendjen për një paqe të përkohshme me osmanët. Një vit më vonë historia, për fatin tonë të mirë, do të merrte rrjedhë tjetër.

Një gazetar i luftës

Njësoj si e famshmja Edit Dërhem, Nopça ishte njëri ndër gazetarët më aktivë nga zonat e luftës në Shqipërinë e Veriut përgjatë periudhës 1910-1911. Më poshtë vijon një ndër shkrimet e tij që i firmoste me "Nga një njohës i mirë i Shqipërisë".

"Si të thuash si një vërtetim të telegramit tonë të datës 23 të muajit të shkuar gazeta 'Zeit' sjell sot një artikull të një dëshmitari okular mbi mënyrën se si Shefqet Turgut Pasha po fillon të shfarosë të gjithë katolikët e Vilajetit të Shkodrës. Veprimtaria e tij për shfarosjen e tyre është e planifikuar qysh prej kohësh dhe konsiston në atë që, në vend të shpatës dhe të zjarrit, të përdorë mjete të tjera, pikërisht urinë dhe malariën për të arritur zbatimin e planit. Meqë, para së gjithash, lidhur me këtë plan i duhet kohë, gjenerali, dikur tepër luftarak, në mënyrë që të fitojë kohë, shpall se afati i amnistisë po përzgjatet nga njëra javë në tjetrën, sepse ndërkohë uria dhe malaria megjithëse janë mjete të sigurta, por janë mjete që veprojnë ngadalë. Me vdekje nga uria u dënuan nga Turgut Pasha fiset që banojnë në jug të kordonit të trupave të tij, të vendosur kundrejt malësorëve dhe në veri të Drinit, në zonën e lumit Kiri dhe Leshnica, ku numri i frymëve, si pasojë e ardhjes së njerëzve nga Dushmani, Toplana dhe Shala arrijnë në rreth 8 mijë. Këta janë të gjithë të afërmit e fiseve Shala, Shoshi, Plani, Gjani, Suma, Shllaku, Dushmani dhe Toplana. Këta njerëz janë shtypur nga trupat, furnizimi i tyre me miell është ndërprerë dhe kështu ata janë të detyruar të therin kopetë e tyre, kështu që të rrënohen ekonomikisht. Kur njerëzit e këtyre fiseve u përpoqën të arrijnë në Mal të Zi nëpër kordonët e trupave turke, në mënyrë që t'u sillnin bukë grave dhe fëmijëve që po vdisnin nga uria, ata sipas mundësisë u qëlluan për vdekje nga trupat perandorake, si për shembull në datën 8 të këtij muaji.

Në mënyrë të pabesë i ekzekutoi Turgut Shefqet Pasha në Bregun e Matës edhe 16 mijë njerëz të tjerë jo kryengritës, për shkak të fesë së tyre katolike. Këta njerëz e kalojnë dimrin me gjithë familje në tokat moçalore të Adriatikut, paguajnë menjëherë taksën dhe çdo vit kur në Bregun e Matës fillon malaria, ata tërhiqen bashkë me kopetë e tyre për në bjeshkë. Kot e detyroi Turgut Pashën Sadedini, diplomati turk në Cetinë, që edhe sivjet t'i linte këta njerëz të tërhiqeshin si zakonisht në bjeshkë. Turguti e di mirë se kopetë e këtyre njerëzve gjatë verës patjetër do të ngordhin në moçalishtet e Bregut të Matës. Ai gjithashtu e di se asnjë njeri nuk është në gjendje t'u rezistojë etheve të malaries së këtij vendi. Për këtë arsye nuk i la njerëzit të dilnin nga moçalishtet, por e shtyu bisedimin në Podgoricë dhe afatin e amnistisë e përzgjati kaq shumë, derisa malaria në Bregun e Matës që tashmë ka shpërthyer, e ka kryer detyrën e saj sipas qëllimit xhonturk. Për sa kohë që bëhet fjalë për kryengritësit gjendet një pretekst për pabesinë xhonturke, por sapo është fjala për qytetarët besnikë turq, të cilët përndiqen vetëm sepse janë të fesë katolike, atëherë zhduket edhe ky pretekst.

Edhe për sa kohë do të vazhdojnë t'i bëjnë sehir shtetet e qytetëruara këto turpe?"

Nga një njohës i mirë i Shqipërisë
Reichpost, Vjenë, 13 korrik 1911.

(Për këtë shkrim u përdorën të dhëna nga: Udhëtime nëpër Ballkan [Kujtime nga jeta e Franc Baron Nopça]; Përgatitur për botim nga Robert Elsie; përktheu Ilirjana Angoni, Plejad, Tiranë 2007.



LIBËR ME INTERES PËR STUDIUESIT E PËRMASAVE AKADEMIKE


Mentor Quku, *MJEDA*, 6/1 (Bibliografia), Tiranë, 2012, faqe 327.

Sapo ka dalë nga shtypi vepra e fundit e serisë monografike “*MJEDA*” e studiuesit Mentor Quku. Për dhjetë vjet (2003-2012), autori ka botuar dhjetë vëllime të kësaj monografie: *Mjeda-1, Rinia (1866-1888)*; *Mjeda-2, Albanologu (1888-1899)*; *Mjeda-3, libri i parë, Alfabeti (1899-1912)*; *Mjeda-3, libri i dytë, Liria (1899-1912)*; *Mjeda-4, Identitet (1912-1925)*; *Mjeda-5, Gjuhëtari (1925-1937)*; *Mjeda-6, libri i parë (Bibliografia e atij)*; *Mjeda-6, libri i dytë (Bibliografia për ate)*; *Mjeda-7, Bashkëkohësit*; *Mjeda-8, Album*.

Vëllimit *Bibliografia e Mjedës* i prin një *Parathënie* shkoqitëse e autorit për karakterin nxitës e hulumtues të krijimtarisë së Mjedës, metodat e përdorura në vlerësimin dhe komentimin e veprave të tij, për orientimet tipologjike të bibliografisë së teksteve të Mjedës, për njohjet e gjertanishme dhe pritjet e kërkimeve të reja, për problemet e dala deri me tash në identifikimin e disa dorëshkrimeve autografi të Mjedës dhe moshës së krijimit e botimit të veprës së tij, për çështjet e unifikimit të pseudonimeve dhe madje teksteve pa asnjë shenjë identifikuese etj. Pra, shqetësimet, shpjegimet dhe diskutimet në këtë hyrje dalin të karakterit historik, teorik dhe pragmatik, prandaj janë me interes sa për studiuesin e përmasave akademike po aq edhe për lexuesin e interesimeve përgjithësuese.

Në tërësinë e saj vepra *Bibliografia e Mjedës* është ndarë në dy pjesë: 1. *Veprat e Mjedës botuar deri në vitin 1937* dhe II. *Vepra e Mjedës nga vitit 1937 deri më 2010*.

Pjesa e parë e veprës është një përpjekje titanike e autorit për të hulumtuar dorëshkrimet dhe botimet e Mjedës, veprat e panjohura të tij dhe komentet e zgjeruara të fatit të tyre nga dorëshkrimi autograf deri te botimi e ribotimi i tyre ndër vite. Fjala është veç tjerash për veprat “*Çerdhja e zogjvet*”,



“*Shahiri Elierz*”, do bejta qi kaa qit N.M. i S.J., “*Miku Bestar*”, *Haannamia per senne 1889*, “*Jeta e Scetit Sc'Gnon Berchmans*”, “*Vorri i Skanderbegut*”, “*Vaji i bylbylit*”, “*T'perghjemit e εojs Bëkume*”, “*Albanisesche Studien*” (“*Studime shqiptare*”), VI, “*Fjalori etimologjik*”. Krakov, 1891-1896, “*Gramatikë e*

krahasuar e gjuhës shqipe”, vepër hipotetike e Mjedës, “*Fjalor botanik*”, dorëshkrim autografi Mjedës, vepër e papërfunduar, “*Promemoria e 22 shtatorit 1902*”, “*Epistolar*” etj.

Pjesa e dytë e vëllimit përfshinë një regjistër të plotë dhe shumë të pasur të botimit të veprave (poezi, studime dhe përmbledhje veprash) të zgjedhura apo më të plota në gjuhën shqipe apo edhe të përkthyer në gjuhë të huaja. Fjala është për botimin e tingëllimave të tij *Lisus*, *Scodra*, poemthit shumë të popullarizuar *Vaji i bylbylit* si dhe përmbledhjeve me poezi për të vegjël, për të rritur apo edhe përmbledhjes me studime të karakterit gjuhësor, historik dhe letrar, nga viti 1938 deri në ditët tona.

Duke përfunduar këtë fjalë hyrëse për vëllimin që po e përmblyll kolonën e studiuesit të shquar Mentor Qyku, *Mjeda*, mund të konstatojmë se *Bibliografia Mjeda*, nuk është vetëm një bibliografi e zakonshme e bërë deri më tash për Ndre Mjedën apo edhe për personalitete të këtij formati në letrat shqipe. Ajo është më shumë se bibliografi saktësimesh dhe komentimesh. Ajo është bibliografi referimesh, përplotësimesh, vlerësimesh e rishikimesh përmasash të thella filologjike, tekstologjike e shkencore, që brezit të ri të mjedologëve do t'iu shërbejë si një vademekum i përditshëm.

Dom Nike Ukgjini

FESTË PËR POETIN MJEDA

Bushat- Kukël, 1 gusht 2012



Një veprimtari multidimensionale ka shoqëruar 75 vjetorin e Vdekjes së klerikut të njohur katolik, poetit të madh kombëtar Dom Ndre Mjeda, një bashkëpunim i vyer mes qendrës muzeore Ndre Mjeda, Qendrës së Studimeve Albanologjike dhe komunës Bushat. Veprimtaritë të organizuara me 1 gusht, 2012, në Bushat dhe Kukël, janë ndarë në dy pjese, konferencën shkencore dhe veprimtarinë festive që lidhej me përrurimin e shtatores monumentale të Mjedës dhe të qendrës muzeore në Kukël.

Në kumtesat e mbajtura në Komunën Bushat, nga studiues të njohur shqiptar si prof. dr. Ardian Marashi, Gjovalin Shkurtaj, Mentor Quku, Tonin Çobani, Klara Kodra, Alfred Çapaliku, Dom Nikë Ukgjini, si dhe studiues të njohur nga Kosova e Maqedonia etj, si: Zeqirja Neziri, Begzad Baliu, Mimoza Priku, Mustaf Ibrahim, Mark Marku, etj, u fol për “mallin romantik të Mjedës”, për esencjalizmin në krijimtarinë e tij, apo krijimtarinë letrare për fëmijë, për përbashkësinë e gjuhës si dëshmi e njësisë së kombit shqiptar në veprat e Mjedës, për Rilindjen e Mjedës në kolanën e prof. Qukut, Mjeda si misionar i Dijes, Mjeda si mjeshtër i madh i gjuhës etj.

Më pas në veprimtaritë festive, organizuara në orët e pas ditës në Kukël, Imzot Angelo Masafr, kryepeshkv i Shkodrës, bekoj mjediset e kësaj qendre muzeore duke

ftuar të pranishmit për lutje dhe vizita, e ndërkaq u bë dhe përrurimi i shtatores monumentale. Projektin për rikthimin në identitet e ka bërë arkitekti Zef Çuni. Qendra Muzeore “Ndre Mjeda”, më 16 dhjetor 2011 është shpallur Monument Kulture ku ruhet një kujtesë 100-vjeçare e Mjedës, në fushat e poezisë, gjuhës, letërsisë, diplomacisë, politikës. Ajo u realizua nga skulptori Sadik Spahia pa asnjë lloj shpërblymimi dhe u financua nga aktivisti i mirënjohur pukjan nga New York, Zef Balaj.


Pjesa festive u përcoll bukur dhe nga një koncert artistik me këngëtarë të zonës dhe ansamblit “Mirdita”. Ky ishte padyshim dhe dedikimi më i bukur që i behët një prej kolosëve të iluminizmit dhe shtetformimit shqiptar në këtë 100 vjetor, nga famullitari dhe studiuesi i njohur Dom Nikë Ukgjini, të cilin në fund të koncertit, komuna Bushat e shpalli qytetar nderi të komunës Bushat.

Kjo qendër do të jetë në funksion të plot të promovimit të turizmit kulturor ndërkombëtar.

Qendra është restauruar me ndihmën e grupeve dhe individëve të caktuar, Kryedioqeza e Shkodrës, Karitasi Gjerman, Komuniteti “Zoja e Shkodrës” nga New York, si dhe individë, si Konsulli i Nderit i Austrisë, etj.



VITRINË LIBRI



Mentor Quku

MJEDA

ILAR, Tiranë 2012



Konferenca Ipeshkvnore e
Shqipërisë

FE DHE ATDHE

Tiranë 2012



Maximilian Lambertz

POSTA E SHQYPNIËS

Qendra e Studimeve
Albanologjike, Tiranë 2011

KUMBONA E SË DIELËS
revistë fetaro-kulturore dymujore
e Kryedioqezës Metropolitane Shkodër-Pult
Tirazhi: 1000 kopje
Çmimi: 100 lekë (Evropë: 2 Euro)
Parapagimi vjetor 600 lekë
(Evropë: 12 Euro)
e-mail: n_ukgjini@yahoo.it
Web page: www.kishakatolikeshkoder.com
Adresa: Arqipeshkvia Shkodër,
Sheshi "Gjon Pali II"
Shtypur në Entin Botues "Gjergj Fishta" - Lezhë

KUMBONA E SË DIELËS

Viti XXVII, nr. 7/8 (442-443) Korrik - Gusht 2012